

*L. Thomas Konom
Nenpunës në Zyri e Spotekan
Këde*

VITI i V — FRUER — MARS 1933 — Nr. 2-3

NORMALISTI



Jo në dijën, por në
vullnetin e fortë
qëndron vlera
e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshme "NORMALISTI,"
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja "SAIDE," Elbasan
1933

Muzeu i Shkollës Normale

copy

M b r e n d i j a

| | Faqe 1 |
|--|--------|
| Dedikim i Normalistit për D. Radën | 4 |
| Gerolamo de Rada dhe Milosau | 6 |
| Është i nevojshëm libri i këndimit në shkollën fillore ? | 8 |
| Mësues për herë të parë | 10 |
| Arsimtari | 11 |
| Pak fjalë për përgjigjen | 13 |
| Detyra | 16 |
| Vjerrsha " V a j e " e Çajupit | 18 |
| Provë mësimi — Mësim jete, Arithmetikë | 20 |
| Provë mësimi — Këngë | 22 |
| Provë mësimi — Mësim jete | 24 |
| Provë mësimi — Dituni Natyre | 27 |
| Provë mësimi — Arithmetikë | 30 |
| Provë mësimi — Gjuhë | 32 |
| Provë mësimi — Histori | 34 |
| Vdekjet | 35 |
| Bashkëpunimi | 36 |
| Kopshti dhe Trandafili i zhuritun | 39 |
| Sporti edhe mjeku | 41 |
| Vjerrsha për shkolla fillore | 42 |
| Fjalë të urta | 44 |
| Anekdotat | 46 |
| Lajme të Shkollës | |
| Posta e jonë | |

E përkohëshmjia " N O R M A L I S T I ," DEL NJI HERË NË MUEJ.

E botojnë nxânësit e Normales.

| | | | | |
|-----------------------|------|---------|-------------|------|
| S. Alliu | '33. | ndihmës | V. Muzhofi | '34. |
| r: Q. Guranjaku | '33. | " " | M. Shahinaj | '34. |
| Arkëtar: J. Dhimitraj | '33. | " " | V. Kasso | '35. |

P a j t i m i : për gjashtë numra 2 Fr. ari
Nji numër kushton 2 Lekë.

Për kujtim e nderim

Ky numër i "Normalistit," i kushtohet atit t'onë të shdukun, poetit të madh, Gerolamo De Radës, i cili në këtë muej mbushi tridhetë vjetorin e vdekjes së 'tij.

Etënit t'onë të shdukun.

Gerolamo de Rada.

"Fisi Shqiptar nuk do të shuhet;
gjaku i Shqiptarit nuk do të humbasi,"
(G. de Rada)

Kanë kalue tridhetë vjetë ç'prej vdekjes së vjershtorit të math, atdhetarit Shqiptar në zã e letrarit të vjefshëm, Gerolamo de Radës. Kanë kalue tridhitë vjet, të cilët mund t'i quejmë vjet harrese, ç'kur është shdukun fytyra e shkëlqyeme e atij njeriu, i cili e ka mbajtur të gjallë gjithë jetën dashurin për atdheun e 'tij të shumvuejtun, për Shqipnin.

Gerolamo de Rada u-lind në vjetin 1814 në katundin e vogël Macchia n'Itali. Ishte bir'i një prifti dhe mësimet e para i mori në katundin e vet; mësimet e nalta i mbaroi n'universitetin e drejtësis dhe të letrave në Napoli, e mandej e emnuen si profesor i gjuhës Shqipe në "Colegio Albanese," qi ishte te qyteti i vogël San-Demitrio-Corone. Këtu, mbassi kryente detyrën si profesor, rrinte i mbyllun në kthinën e vogël të studimit dhe aty punonte dit' e natë pa u-mërzitun edhe shkruente libra për Shqipnin, me anën e të cilëve kallzonte jetën e kalueme të Stërgjyshëve t'onë, trimnit dhe vuetjet e 'tyne, edhe dëshpërimin e math, qi ndiejshin Shqiptarët e Italis, se ishin larg atdheut të 'tyne

G. de Rada gjithë jetën ka punue për me e përhapun sa më tepër gjuhën Shqipe edhe është i pari, qi e ka studjue lidhjen dhe farefisnin ndërmjet gjuhës Shqipe dhe gjuhës së vjetër

Pellasse. Si atdhetar, de Rada, gjithmonë rrinte i frymëzuem me një fuqi të hyjneshme dhe me zell të math e pa dëpunonte për krijimin e ndërgjegjes kombëtare. Si vjerrshëtor na çfaq me ngjyra të gjalla natyrën e njimendët, tue u-mundue me na kallzue të msheftat e 'saj dhe të shpirtit të njeriut.

Prej shkrimeve të 'tij më të përmendun janë. Serafima Topia, copët e një poeme shqipe, Historia e Shqipnis (Italisht), gramatika e gjuhës shqipe, Shqipnia, Skënderbeu, autobiografia e 'tij e shumë të tjerë. Ka botue edhe një të përkohshme me emrin: "Flamuri". Por ajo që quhet kryevepra e de Radës është "Milosaun". Shkaku, që e shtyni de Radën me shkruë këtë kryevepër, është ky:

"De Rada na kishte zënë dashuni me vajzën e bariut të 'tij. Dashunia ishte aq 'e fortë sa nuk i ndahej aspak. Kjo dashuni ka një vlefë të madhe, pse shkakëtoi që de Rada të bëhet vjerrshëtor shqiptar. Siç thamë më sipër, de Rada kishte nisun t'i bënte vjerrshat italisht, mirpo e dashuna e 'tij, si vajzë katundari, nuk e dinte italishten e sidomos italishten letrare. Pra, që 'ta kuptonte e dashuna e 'tij, de Rada nisi të bëjë vjerrsha shqip. (Dr. Stefan Shundi, "Gazeta e Tiranës", V. I=1932)

Në këtë vepër nuk takojmë madhështinë e fantazi përtej mendjes së njeriut, por vetëm një pastërti mendimesh gjithmonë të drejta e të thjeshta edhe plot harmoni. Në këtë poeti flet ç'ka verën. Këtu shofim se është tue u-qamë një zemër e pastër, një zemër e njëj truni, që është mbushun me mendime të bukura, e, tue u-fellue më gjatë, kemi me zbulue ngjarjet e botës edhe fytyrën e vërtetë të natyrës dhe të jetës.

Por Milosaun që e kanë çmue edhe të huejt, ne Shqiptarët nuk ia dijmë ende vlerën edhe nuk e njofim aspak, sepse deri tashit asnjë nuk është përkujdesun për me botue së paku një blen të ri të kësaj vepre. Kështu kjo vepër, si shumë vepra të tjera, po na shduket pak nga pak e, kur ka me na ardhë ndër mend për me e shtypun përsëri, ndoshta nuk mund ta gjejmë, sepse do të na ketë fluturue fare nga rafti, e atëhere vaj hallit për djersën e shkrimtarit.

G. de Rada ishte njeri i detyrës edhe i pëlqente jeta e veçue: larg zhurmave dhe larg dëfrimeve. Gjithë jetën ka qenë i vorfën, edhe shumë herë i mungonte edhe kafshita e gojës. Me gjithë atë vorfëniya nuk ia paksonte aspak dëshirën për pu-

në.

Nga puna e pareshtn, nga dëshpërimet se gjindesh larg atdheut, nga vorfënia e padame edhe nga pleqënia, Gerolamo de Rada u-dobësue nga trupi dhe i erdhi fundi i jetës. Prej dëshpërimit të math, se nuk e pa Shqipnin të lirueme, pak orë përpara vdekjes thirri me zâ të naltë: "**Fisi Shqiptar nuk do të shuhet; giaku i Shqiptarit nuk do të humbasi.**",- Edhe më 28 Shkurt—d. m. th. më 28 të k. mueji 1903,—në kohën e mëngjesit, dha shpirt i qetë dhe me ndërgegje të pastër.

Vdekja e de Radës dëshpëroi gjithë ata, qi e njifshin dhe që ia dijshin vlerën e 'tij e shumë njerës me rëndësi kanë shkruue për veprat dhe për jetën e vjerrshëtorit t'onë. Kushërini i dashun i vjerrshëtorit, Dr. Michel Marchiano-i, në një shkrim, qi ka shkruue për vdekje e de Radës, ndërmjet të tjerave thotë edhe këto:

" De Rada shkoi nga kjo botë i përlun si çdo njeri i shkëlqyem. Por ka me mbetun si një fantazëm, që ka me tmerue anmiqt e Shqipnis, e cila (fantazëm) ka me shkëlun me madhështi, tue u kallun frikë të huejve, porsi shpata e të madhit Kastriot, q'i shtynte tej e më tej kordhat e Turqëvet. Gerolamo de Rada ka me mbetun për jetë një lavdi e kombit Shqiptar dhe një symbol i virtytit."

De Rada pra ishte njeri i përlët, i mençun, fillosof, vjerrsh-tor, shkrimtar dhe udhëheqësi më i math Shqiptar i qindvjeto-rit të XIX.

Por, si Naim Frashëri me shokë, ashtu edhe Gerolamo de Rada vdiq larg atdheut të vet, vdiq pa e pamë Shqipnin të lirë edhe sot eshtnat e 'tij dirgjen në vend të largët, m'atë anë t'Adriatikut. Pra qysh atëhere kanë kalue, si thamë, tridhitë vjet në harresë. Themi vjen harrese, se deri më sot fare pak e kemi kujtue; rrallë, fort rrallë, i ka ra puna ndonjenit për me shkruue dishka për veprat e'tij; s'asht përmendun, po thue, aspak nëpër shkollat, dhe jetëshkrimi i de Radës nuk është shkruue deri sot prej ndonjenit, që e ka njoftun s'afërmi dhe qi i ka studjue mirë veprat e'tij.

Rinija Shqiptare le ta kujtojë me përunjësi mbas tridhitë vjetësh emnin e njëj ati të 'saj të shdukun dhe le të gjunjëzohet sot përpara kujtimeve të paharrueme të të madhit njeri letrar dhe atdhetar, Gerolamo de Radës.

St. Spasse '32.

Gerolamo de Rada

Milosau

Shënim: Po botojmë këtu tri këngë të Milosau-t për me shijue pak kryeveprën e de Radës.

Kangjel i I.

Ljis jeta kish ndërruar,
 Uj të ri ndë dejt
 Kaljthëruar te jeta e ré:
 Po lumbardh e Anakreonit
 Rronej Teemp e moçme.
 Nd 'uj një ditë vate te malji
 E s'u-pruar si kish zakon.
 Vet që atë s'e thajti bora
 S'e përgjaku akuli,
 Se m'u-resht njera që ra
 Tek e bardha shpia ime.
 Kur te drita dheu më shpië
 U-zbulua je dejt.
 Si hare që delj për sish,
 Mua më zgjoj tue ljuturuar
 Qelqevet finestëres.
 M'u-pataksa e ruata jashtin:
 Rrusht pak skalankuur
 Dheut ene i kim hjee:
 Ljulje ljiu të hapura,
 Nd'era i tunden e përzien.
 Nd'at minulj qeshënjën
 Si ato ljulje, qielli
 Ti ruaje e së quljtoje
 Një mbujinë njërezish.
 Kalezoret mbë dhenat
 Mbajnë kangjelë, nga i hoj
 Ahjena nder t'ime motëra
 Keshja rrënë; e mema ime
 Emrin t'im thoj për ndë shpië.
 Një hareé m'u rodh te kurmi
 Si haré mbramjes te shtrati,

Dy buzë të qeshme
 Një herje të bardhë,
 At mbramba dukëshim
 Kangjel i III.
 Ishë e mbramja e Shën Mërisë
 E vashat lëshuame
 Ka të bredhurit, ndër dierë
 Fjissin se ndër vatërat
 S'ünë të jatërat të vrërët
 Paru zëj një anangassi
 Ndaheshim aar e limeerë:
 Prttej nata tek na,
 Gadanare bilja zonjash
 Të luajn të përdorme
 Me të nderëm bür buljari
 Engjellit ashtu nder qiellë,
 Më të mirë se njerzit,
 Mbanjën veç hareén e tire.
 Dolla u Rodhë, e kopshtin
 Pam elbit e përfrushur
 Ecnja për nën ullinjte
 Posht, te kroi, me katrë vasha,
 Me të bardhë shqepë në kriet
 Erdhë e bija e Kologresë:
 Dukëshin kallëzë të karpisur.
 Valle— fanmirë kush na duall
 Mbi Rodhën fusha mirë,
 Si vandilje e Arbërit!
 Fanmirë ajo kopilje
 Ka e jema e puthures,
 Çë te krahu t'i pushojë!
 Ka të niset e magjepsur
 Ka Vorea të dejtut
 O ka e bardha Mjesditë?

Është i nevojshëm libri i këndimit në shkollën fillore?

Shumë herë kemi rënë në bisedim me shokët për përdorimin ose jo të librit të këndimit në periudhën e mesme të

shkollës fillore.

Duke u-mbështetur në shkrime të shkruara prej mësonjësve të provuar në lëmë të didaktikës, kemi qënë dhe jemi të mendimit që libri i këndimit të mos perdoret në këto klasa, pse është i padobishëm e i papërshtatëshëm në kohërat e soçme.

Disa mësonjës, të tilla mendime mbi mos-përdorimin e librit të këndimit në periudhën e mesme të fillores, i quajnë paradokse. Këta kanë të drejtë t'i quajnë kështu këto mendime, pse besimi i math, që kanë në mendimet didaktike të vjetëruara, nuk i lë të thonë të vërtetën.

Koha e soçme kërkon të largohemi nga drejtimet pedagogjike të vjetra dhe të hyjmë e të jetojmë në mendimet e ra, të cilat ecin paralel me shvillimin e përparimin e njeriut.

Prandaj me këtë artikull nuk u drejtohem mësonjësve, që mbajnë akoma thesarin e mendimeve pedagogjike të vjetëruara, por shokëve t'otë, mësuesve të rinj që kanë dalë tani nga Normalet ase janë duke dalë dhe u bëjmë këtë pyetje, të cilën e kemi njerrë nga një artikull të shkruar në të përkohshmen italiane "Educazione Nazionale," që e drejton pedagogu i shquar italian, Lombardo-Radice.

Pyeteja është kjo: "Nuk mund të mësohet në një shkollë fillore pa tekst këndimi?"

Mund të përgjegjeni: "A mund një kopshtar të punojë pa vegla e mjeshtëris së 'tij?"

Po veglat e kopështarit janë shumë të ndryshme nga ato që duhet të përdorë një mësonjës. Mësonjesi i mirë veglën e 'tij, "Ibrin e këndimit," mund ta zavëndësojë me të tjera vegla më të përdorëshme e më të përshtatëshme.

Është e vërtetë që libri i këndimit është koncentracioni në me rëndësi i shkollës fillore, por është dhe më e vërtetë se drejtimet e ra pedagogjike kërkojnë ta çlirojnë shkollën nga këndimi "mekanik," e "i shpejtë," dhe në vënd të 'tyre të vënë këndimin "ekspresif," si më i përshtatëshëm e më teknik.

Programet shkollore nuk duhet të shënojnë copat e këndimeve e të vjershave që do të mësohen, por duhet t'i lënë liri veprimi mësonjësit që të përdorë, sipas rasave e ndodhive, ato më të nevojshmet për t'i arrirë qëllimit të mësimi sa më mirë e plotësisht.

Çdo mësim informatif, si histori, gjeografi, moral, e dituri

histori natyre duhet të përcillet prej këndimit relativ, që një mësonjës gjenial duhet ta zgjedhë nga librat e bibliotekës së tij, nga të përkohëshme e gazeta të ndryshme.

Kurse lënda, që do të mësohet, shvillohet mirë nga mësonjësi, sqartohet me eksperimenta, fytyra, vizatime dhe plotësohet me copa këndimi të zgjedhura atje e këndeje, për ç'punë duhet libri i këndimit?

Mund të thoni: "po kallzimi i brëndis së copës së kënduar dhe ushtrimet gramatikore ku mund të bëhen, kurse nxënësit nuk kanë përpara një tekst këndimi të njënjëshëm për të gjithë?."

Kallzimi i brëndis së copës së kënduar bëhet më mirë në këtë menyrë, pse kur u këndohet nxënësve një librër i ri, ata do të kenë interes më tepër për atë që kallzohet, e vëmëndja e tyre do përqëndrohet atje edhe gjithë klasa do të rrijë në qetësi. Veç këtyre u zgjohet atyre dhe shija e këndimit, pse libri i këndimit që kanë përditë i mërzit dhe nuk kanë ndonjë interes për atë.

Edhe ushtrimet gramatikore mund të bëhen pa libër të këndimit në formë përligjërimit e me anë pyetjesh.

A nuk janë të mjafta këto për një nxënës të shkollës fillore?

V. Nasto'30.

Mësues për herë të parë.

Tue i këthye krahet jetës teorike, asaj jete sa t'ambëlloqë edhe të dashtun, i këthiem fytyrën jetës praktike, kësaj jete sa të vështirë aqë edhe të drashtun; tue i thënë lamtumirën e funjit çerdhes s'onë, Normales, e vendit pesëvjeçorë të nxënësis, i thamë "mirë se të të gjejmë, vendit të detyrës, vendit të mësuesit. Në fillim, të gëzuem, se po e shifshim të realizueme andrrën t'onë, i u-përvëshëm punës, me atë mënyrë qi bân, ose mund të bājë çdo djal i ri në detyrën e re; por mbasandaj, tue pamë se çdo gjë, qi na e lypshin rastet e minutshme, nuk na e tregonte pedagogjija; tue pamë se edhe profesorët, qi i pyetshim gjithnji, ishin larg, e se mësuesit e çdo çasti, librat a tekstet e ndryshme, na mungojshin, filluem të dëshpërohemi e të kuptojmë vështirsinë e kësaj detyre të rëndë, qi na e quejshim më të lehtë, kur mësojshim shtatë fije histori, tri pedagji, katër gjuhë, e t'jera

Mësues. . . . a e di se ç'do me thënë? Ke mbi krye një tufë njerzish. Këta nuk janë profesorët, qi të japin të kuptoish; nuk janë shokët, qi u jep e të japin një gjë, qi u shfaq e të shfaqin një mendim; por janë nxënësit, bijt e tu, qi kërkojnë gjithnjë t'i koshin me një ushqim (mendor e moral) të mirë, të pastër e naltësues. Je përpara disa shpirtënve të njomë, qi shpejt këthehen nga rruga e mirë, por edhe shumë shpejt nga ajo e keqja. Këtu qindron puna se si e mban frenin, se si rregullon dhe se si e çon në rrugë të mbarë brezin e ri, shpresën e Kombit. Prandaj mësuesija, të cilës ia kishjem ndigjuem zënin, por jo provuem, është e vështirë. Më e vështirë është për mësuesin e ri; për atë qi s'di një gjuhë të huej; e sidomos kur këtë mësues e çojnë me një herë në katund e me klasë kolektive, ku veç bisedimeve e mësimeve, qi bënë në shkollë, si ndigjon gjë veshi për detyrën e 'tij, veçse për kën e bardhë, gomarin e zi, rakën e rrushit e të tjera. Ka të bëjë me katundarë, ndaj të cilët, jo vetëm qi s'fiton gjë, por ka edhe një detyrë edukuese tue përdorë mjeshtrin e butsin e 'tij. Një mësues i tillë duhet të jetë i pajisun kambë e krye me cilësi të mira; duhet të ketë durim, vullnet, dashuni, thjeshtësi, ndërgjegje të pastër, karakter e një takt të mirë; se me këto i vete puna mbarë si në shkollë ashtu edhe jasht kësaj në popull. Me këto fiton dashunin e nxënësve e të katundarve; me këto ia qillon punës, të cilën ia ka besue shteti i 'tij.

Sidomos vullneti e durimi e bëjnë mësuesin të vlefshëm për tash e më të vlefshëm për kohën e ardhëshme; vullneti e çon përpara njerin, dhe durimi e rruen të mos këthehet prapë. Ai njeri qi i ka këto dy cilësi të mira, ai është një nxënës për gjithë jetën; ai e kryen mirë detyrën e 'tij; e ai do të bëhet mësuesi më i mirë i së nesërme.

Rren vehten ai mësues qi thotë: "jam i zoti", se kam mbaruem këtë ose atë shkollë. I zoti është ai, qi e kupton dobësin e 'tij në këtë detyrë të rëndë, qi s'i jep fund jetës së nxënësis e qi vjetët njani mban t'jetrit e zënë tue vijuem mësimin e ndonjij gjuhe të huej.

Të zot e shumë të zot e quejshim edhe na vehten, kur ishëm në shkollë; e bile fandazija e jonë rrënëse na hypte edhe në shkollë më të alta; por kjo besohej, vetëm atëhere kur planet t'ona fluturojshin n'ajër e kur fandazija e jonë gatiente një

bukë pa miellë e pa ujë. Vërtetsija e tashme më bëni të peshoj vehten t'ime e shokët e mij; më bëni të ndjej se në ç'gjiendje jam; e më lajmoi qi t'i përvishem punës me mish e shpirt; më lajmoi të vijoj gjatë jetës s'ime si një nxënës i mirë, për në dasha ta miritoj këtë emën, ashtu si e ka kuptimin e 'tij.

Haki Ballshi '32.

Arsimtari.

Kush është arsimtari?

Arsimtari është flamurtari i liris, i së drejtës dhe i përparimit; krijestari i lavdis kombëtare; rrejtësi i mirë i dijenis; mbrojtësi i çdo ndjese e ideje fisnike; urrejtësi i rrënës e i punvet të liga; është ai që nuk i gëzon përgjithënisht të mirat e kësaj bote.

Arsimtari, njeriu ideal i popullit, me anë të dritës së pashue me të ditunis mundohet të ndrisi mendjet e vogla për njerëz të mëdhëj; kujdesohet për mirërritjen e karakterit dhe për forcimin e vullnetit e të durimit, që janë armët e domosdoshme për çdo njeri, i cili ka shpresë të rrojë me nderë; por nuk e lë më një anë edhe shëndetin e njeriut. Ky është prindi shpirtnuer i fmijvet përgjithnisht dhe ngushëllimtari e shpresëdhënësi i të vorfënvet, i bonjakvet e i të gjymtëvet veçanrisht.

(Arsimtari e bënë vullnetarisht çdo punë të mirë, që të jetë shembull i së mirës jo vetëm për të vegjlit, q'e imitojnë orë e çast e sakaqë, por edhe për të mëdhëjt, q'e verejnë me kujdes.)

Arsimtari është dëshmori i brezit të ri, që mundohet të dali prej errsinës në dritë.

Çfarë kërkojnë nga arsimtari?

Për me pasë arsimtarë t'aftë, çdo shtet ka themelue e organizue shkollat Normale, ku kandidati për arsimtar nxë jo vetëm disa njohni themeltare të ditunis, por edhe shkencën e shpirtit, psikologjin bashkë me ditunit ndifmëtare. Kjo shkencë i duhet arsimtarit jo vetëm që t'i njofi disi vetit shpirtnore të të tjeret, por që të përmirësojë më përpara shpirtin e vet.

Gjithkush e di se nuk mund të shpresohen punë të mira prej një njeriu, që nuk ka shpirt fisnik. (Por në Shqipni kemi shumë arsimtarë t'aftë, që i kanë plotsue mësimet në shkolla të dryshme).

Puna e 'tij, mjeshtria e 'tij e bëjnë arsimtarin që të jetë një nxënës zelltar, një autodidakt i mirë, një puntuer i palodhun. Puna e 'tij nuk ka vlerë vetëm mbrenda katër murevet të klasës

a të shkollës; ai duhet të veprojë edhe përjashta, njësi sikur-se i ka mësues nxënësit e si e ka këshillue popullin. Të gjithë i kanë syt ke arsimitari dhe prej mundit të 'tij presin dishka më tepër se nga ai i të tjerëvet.

Çdo komb sot prej arsimitarit kërkon njerin e math, i cili me fuqin e 'tij mendore të mundet me i shti në punë krahët e të tjerëvet.

Pak fjalë për përgjigjen

Nji mësues i mirë duhet gjithëmonë t'u ketë kujdes pyetjeve, qi i drejton nxënësvet, mbassi të pyetunit është forma më e mirë e më e dobishme për shtjellimin e mësimit.

Të gjithë pra e dinë se ç'rëndësi ka të pyetunit, e unë nuk do të flas ndonji send për mënyrën e të pyetunit, por për atë qi kërkon pyetja. Nji pyetje e mirë kërkon gjithëmonë nji përgjegje të mirë. Nji përgjegje të mirë (në kuptim të vërtetë të fjalës) mundemi me e pasë vetëm prej nji njeriut të pjekun, kurse prej nxënësit kemi vetëm nji përgjegje, e cilla ka nevojë për nji ndreqje e nji komentim. Prandaj zotsia e nji mësuesi nuk është vetëm me pyetë mirë, por edhe me ndigjue përgjegjen e nxënësit me kujdes, me pasë durim deri sa të përgjigjen nxënësit e mandej me e pritë me buzë në gas, kështu qi nxënësit t'i epen lehtësina për nji përgjigje të lirë. Si të përgjigjet nxënësi, duhet ta kuptojë mirë mësuesi se ç'ka dashtë me thënë, me i ndihmue, me e vù në themë, në qoftë se është në gabim, e në fund me e ndrequn.

Nji mësues, po të veprojë në ketë mënyrë, jo qi përfundimin në mësime do ta ketë më të mirë, por edhe me nxënsin do të jetë më i afruem.

Me u-bindë për nji përgjigje të papritun, me ngritë shpatullat prej çudis, me u-shperthye në gas ose me vù në lojë fjalët e nxënësit janë shëja të nji edukatorit të keq.

Me qenë se përgjigjet e nxënësvet të shumtën e herës anojnë në të qeshme, mësuesi duhet ta dijë se s'e bëjnë me qellim, por vetëm pse nuk janë të zotët me i shprehë si duhet; prandaj mësuesi në kësi rastesh duhet të bëjë ç'mos për me i dhënë nxënësit fjalët e nevojshme për me e shprehë atë mendim.

Nji punë e 'tillë kërkon mjaft durim e kujdes, prandaj

mesuesi duhet të veprojë ngadalë e pa gabim.

Po të pyesim një nxënës: "çfarë është një mal?" ai, mbassi të mendojë pak, do të thotë: "është një gjë që njitet". Nxënasi nuk e ka aspak gabim, pse ai shpesh ka ndiem tue thënë: "këtu rruga njitet", e aty ka pa një mal. Kështu ai i ka thënë mësuesit se mali është një gjë që njitet. Mësuesi e quën të gabueme këtë përgjigje, pse i shkon mendja me një herë te bimët që njitën ndër mure e beson se nxënësi s'ka kurrëfarë mendimi për malin, kurse nxënasi mendon se e ka knaqë mësuesin.

Një mësues t'jetër pyet një nxënës: tri bukë, po t'i shumzoish për pesë, sa bukë bëjnë?

— Pesëmëdhjetë bukë.

— Po pesë vetë ka $\frac{3}{4}$ e bukës sa bukë bëjnë?

— Diçka më pak se pesë.

— Jo, ti nuk e kupton, bëjnë $\frac{15}{4}$.

Për të qenë përgjigjeja "më pak se 5" është përgjigje, që nuk mund të quhet e gabueme e që s'meriton një "jo!", aqë kategorike e as atë bisht mbrapa aqë të vrazhtë "ti nuk e kupton". Mësuesi i mendon të katërtat e bukës, por nxënësi vetëm i ändrron.

Kësi shembujsh, të cillët kanë mbrenda përgjigje, që quhen të gabueme prej pakujdesis së mësuesit, mundemi me dhënë me mijna.

Nuk mjafton vetëm vemendja, por duhet që mësuesi të kërkojë prej nxënësit se çfarë ka dashtë me thënë, kështu që nxënësi vetë të nipi ndriçimet për përgjigjen e vet.

Me gjykue keq një përgjigje të nxënësit vetëm prej pakujdesis së mësuesit, është një e keqe e madhe, pse nxënësi do të bjerë në kundërshtim me ato që ka pa. Shkolla gjithëmonë përpiqet që gjënat, që ka pa nxënësi me ia përmirsue e jo me ia zhdukë.

Po t'i thomi një nxënësit e ke gabim, ai nuk do të dijë se kujt me i besue: syve të vet a po fjaleve të mësuesit. Ai do të jetë nën një veprim dyfish, i cili do t'ia voglojë besimin për mësuesin e do t'ia pakojë guximin.

Prandaj duhet gjithmonë të ndijmë një kënaqsi për përgjigjen e nxënësit, në qoftë edhe e gabueme; mandej lypsen gjetë fjalët e veçanta, duhen komentue e mandej duhen persë-

ritë prej nxânësit e ndrequn.

Ne ketë mënyrë nxânësi mund të ketë një fitim menduer të madh, i cili do të jetë i qëndrueshëm.

A nuk është pra ky qëllimi i mësimit?

V. Kushi '32.

Detyra.

Detyra është një barrë e rëndë, të cilën njeriu duhet me doemos ta kryejë edhe e moskryemja e 'sajë krahësohet vetëm me një ndëshkim moral. Kjo është një hua për pagimin e së cilës njeriu duhet të përpiqet shumë. Detyra është e gjatë aq sa jeta e jonë. Fillon nga shtëpija, ku fëmijë kanë detyrë bindjeje e sjelljeje të mirë kundrejt prindëve, dhe prindët kundrejt fëmive të 'tyne. Më vonë vijë detyrat mijdis burrit e grues, mijdis zotënive e shërbetorëve. Po përveç detyrave shtëpijake kemi edhe detyra të jashtme, detyra midis miqsh e fqinjësh, midis drejtorëve dhe nënpunësve e të tilla në mes të të pasunve e të vobegëve.

Jeta e njeriut, ç'prej të lemes e deri në pikën e fundit, është plot detyra, detyra kundrejt të mëdhenjve e të vegjëlve dhe detyra kundrejt njerzish të një shkalle.

Në çdo veprim të jetes s'onë paraqitet dhe një e kryeme detyre, pse njeriu në ketë botë nuk është gjë t'jetër veçse organi, me anën e të cilit do të kryhen gjithë detyrat.

Njeriu, që ka të rranjosun në thelbin e zëmres ndjenjën e detyrës së shejtë, është njeri me kuptimin e vërtetë të fjalës; ai mbetet i ndershëm, i përmendun e i paharuem në zëmrat e atyneve, që e njoftin rëndësinë e 'saj. Njeriu i mirë, njeriu bujar e fisnik nuk shijon gjë më të bukër, nuk ndjen kënaqësi më të madhe sa atë të detyrës.

Detyra është themeli, mbi të cilin është ndërtue shteti: një shtet, ku nënështetasit, nënpunësit dhe autoritetet nuk kryejnë detyrën e 'tyne, për së shpejti ka me u-shkatrruem.

Për ata, që janë frymëzue prej ndjenjës së naltë të detyrës, për ata që detyrën e duen me gjithë zemër, e moskryemja e 'saj është një faj tepër i math; ata që janë mësue në praktikimin e 'saj janë në gjendje të bëjnë fli vehten e 'tyne në rast rreziku tue qëndrue deri në pikën e fundit të jetës. Ndjenja e detyrës e bashkueme me atë të dashunis për atdhën qenë ato, që ndezën zëmren e fytyrës ideale të Skenderbeut të kapercejë Helispontin

mesuesi duhet të veprojë ngadalë e pa gabim.

Po të pyesim një nxënës: "çfarë është një mal?" ai, mbassi të mendojë pak, do të thotë: "është një gjë që njiitet...". Nxënasi nuk e ka aspak gabim, pse ai shpesh ka ndiem tue thënë: "këtu rruga njiitet", e aty ka pa një mal. Kështu ai i ka thënë mësuesit se mali është një gjë që njiitet. Mësuesi e quën të gabueme këtë përgjigje, pse i shkon mendja me një herë te bimët që njiiten ndër mure e beson se nxënësi s'ka kurrëfarë mendimi për malin, kurse nxënasi mendon se e ka knaqë mësuesin.

Një mësues t'jetër pyet një nxënës: tri bukë, po t'i shumzoish për pesë, sa bukë bëjnë?

— Pesëmëdhjetë bukë.

— Po pesë vetë ka $\frac{3}{4}$ e bukës sa bukë bëjnë?

— Diçka më pak se pesë.

— Jo, ti nuk e kupton, bëjnë $\frac{15}{4}$.

Për të qenë përgjigjeja "më pak se 5", është përgjigje, që nuk mund të quhet e gabueme e që s'meriton një "jo!", aqë kategorike e as atë bisht mbrapa aqë të vrazhtë "ti nuk e kupton...". Mësuesi i mendon të katërtat e bukës, por nxënësi vetëm i andrron.

Kësi shembujsh, të cillët kanë mbrenda përgjigje, që quhen të gabueme prej pakujdesis së mësuesit, mundemi me dhënë me mijna.

Nuk mjafton vetëm vemendja, por duhet që mësuesi të kërkojë prej nxënësit se çfarë ka dashtë me thënë, kështu që nxënësi vetë të nipi ndriçimet për përgjigjen e vet.

Me gjykue keq një përgjigje të nxënësit vetëm prej pakujdesis së mësuesit, është një e keqe e madhe, pse nxënësi do të bjerë në kundërshtim me ato që ka pa. Shkolla gjithëmonë përpiqet që gjënat, që ka pa nxënësi me ia përmirsue e jo me ia zhdukë.

Po t'i thomi një nxënësit e ke gabim, ai nuk do të dijë se kujt me i besue: syve të vet a po fjaleve të mësuesit. Ai do të jetë nën një veprim dyfish, i cili do t'ia voglojë besimin për mësuesin e do t'ia pakojë guximin.

Prandaj duhet gjithmonë të ndijmë një kënaqsi për përgjigjen e nxënësit, në qoftë edhe e gabueme; mandej lypsen gjetë fjalët e veçanta, duhen komentue e mandej duhen persë-

ritë prej nxânësit e ndrequn.

Ne këtë mënyrë nxânësi mund të këtë një fitim menduer të madh, i cili do të jetë i qëndrueshëm.

A nuk është pra ky qëllimi i mësimi?

V. Kushi '32.

Detyra.

Detyra është një barrë e rëndë, të cilën njeriu duhet me doemos ta kryejë edhe e moskryemja e 'sajë krahësohet vetëm me një ndëshkim moral. Kjo është një hua për pagimin e së cilës njeriu duhet të përpiqet shumë. Detyra është e gjatë aq sa jeta e jonë. Fillon nga shtëpia, ku fëmijët kanë detyrë bindjeje e sjelljeje të mirë kundrejt prindëve, dhe prindët kundrejt fëmijëve të 'tyne. Më vonë vijnë detyrat midis burrit e grues, midis zotënive e shërbetorëve. Po përveç detyrave shtëpiake kemi edhe detyra të jashtme, detyra midis miqsh e fqinjësh, midis drejtorëve dhe nënpunësve e të 'tilla në mes të të pasunve e të vobegëve.

Jeta e njeriut, ç'prej të lemes e deri në pikën e fundit, është plot detyra, detyra kundrejt të mëdhenjve e të vegjëlve dhe detyra kundrejt njerzish të një shkalle.

Në çdo veprim të jetes s'onë paraqitet dhe një e kryeme detyre, pse njeriu në këtë botë nuk është gjë t'jetër veçse organ, me anën e të cilit do të kryhen gjithë detyrat.

Njeriu, qi ka të rranjosun në thelbin e zëmres ndjenjën e detyrës së shejtë, është njeri me kuptimin e vërtetë të fjalës; ai mbetet i ndershëm, i përmendun e i paharuem në zëmrat e 'tyneve, qi e njoftin rëndësin e 'saj. Njeriu i mirë, njeriu bujar e fisnik nuk shijon gjë më të bukër, nuk ndjen kënaqësi më të madhe sa atë të detyrës.

Detyra është themeli, mbi të cilin është ndërtue shteti: një shtet, ku nënshitetasit, nënëpunësit dhe autoritetet nuk kryejnë detyrën e 'tyne, për së shpejti ka me u-shkatruem.

Për ata, qi janë frymëzue prej ndjenjës së naltë të detyrës, për ata qi detyrën e duen me gjithë zemër, e moskryemja e 'saj është një faj tepër i math; ata qi janë mësue në praktikimin e 'saj janë në gjindje të bëjnë fli vehten e 'tyne në rast rreziku tue qindrue deri në pikën e fundit të jetës. Ndjenja e detyrës e bashkueme me atë të dashunis për atdhën qenë ato, qi ndezën zëmren e fityrës ideale të Skenderbeut të kapercejë Helispointin

e të hudhet në gjinin e Shqipnis së mjerë për ta shpëtue prej zgjedhjes barbare. Nji fytyrë t'jetër shembëllore e detyrës për ne Shqiptarët, është e ka me qenë Sovrani i ynë, August, i cili, tue qenë i pajisun me ndjenjën e naltë të detyrës, ka bërë e po bën therorit më të mëdha për Shqipnin. Detyrën kundrejt atdheut heroi i ynë kombtar e ka çfaq në shumë raste, ka shkue drejt udhës së mbarë tue mos u-trembun aspak prej sulmimeve trathore, e mendimi i 'tij ka qenë e është: "detyra kundrejt atdheut është më e naltë se ajo kundrejt prindëve",

Historija na jep shemblla fatosash të shkelqyeshëm, qi lënë jetën e 'tyne për të kryemen e detyrës.

Në luftën e famëshme midis Francës e Spanjës, qi u-bër më 1643 në Rocroi, ushtarët Spanjollë të frymëzue prej ndjenjave të nalta te detyrës nuk i lënë vendet e 'tyne, porse luftuen me trimni të pashoqe, deri sa mbetën të gjithë të vramë. E princi francez Condé, tue pamë fatosat e detyrës, tha: "në qoftë se nuk kishjem me fitue, kishjem me dëshërue vdekjen porsì këta",

Admirali i famshëm Angles, Nelson-i, tue qenë i pajisun me ndjenjën e shënjtë të detyrës kundrejt atdheut të 'tij te dashun, luftoi me trimëni të pashoqe e ushtarvet të 'tij u dha zëmër tue u thënë: "seicili të kryejë detyrën e vet; ketë pret Anglija", e, kur ndërroi jetë mbas nji fitimi të shkëlqyeshëm, tha: "i falem të Gjithfuqishmit, se detyrën kundrejt atdheut e bëna",.

Mundet qi njeriu të mos jetë i pasun as moralisht as materialisht, porse është për t'u-nderue e për t'u-lavdue, kur e ka zëmër të qindrueshme e shpirtin fisnik në të kryemen e detyrës.

"Nji derhem punësh të mira, " ka thanë nji fillosof i vjetër, "vlen më tepër se nji okë dituni", e me këtë kështu nuk desh me përbuzë shkencat e ditunis, porse për të tregue se ai, qi ka shumë idë, duhet këto t'i lidhi me punë të mira. Mundet qi njeriu të tregohet i naltë, d. m. th. të çquhet në nji mjeshtëri, në mësimet, shkencat e t'jera, porse në pikëpamje të ndjenjës së detyrës, t'asaj detyre qi mbën në këmbë e rregullon shtete e mbretni, të jetë më i ulët në krahasim me katundarin e vogël e të paqytetnuem. Jeta e njeriut është nji luftë, kundër së cilës çdo njeri duhet të luftojë, tue qëndrue në vendin, qi i është caktue, i patrazuem e pa frikë deri në pikën e fuudit,

Program' i jetës s'onë duhet të jetë: "dëshirë e fortë, guxim dhe përballje në të kryemen e detyrës „.

Fuqija e detyrës është një dhuratë hyjnore, që duhet me çdo mënyrë të përpiqemi të mos e prishim, tue e përdorun në punë të mira. Dëshirën duhet ta zbatojmë mbas ligjeve të ndërgjegjes e mos me e ulë në gjënat e sipërfaqshme të jetës. Ai, që me anën e dëshirës së 'tij (vullnetit) të lirë fiton shprehin e shpirtmirësis, është me të vertetë i mirë, i bukur e i fuqishëm.

Perkundrazi ai që nuk përmban vehten, ai që nuk është i zoti të frenojë dëshirat e 'tij, ai për së shpejti bëhet robi i 'tyne e lidhet me zinzhirin e fortë të shprehis së keqe.

Ne qoftë se njeriu nuk nxitet prej një dëshire të lirë, nuk mundet me bënë ndonji gjë të naltë. Për të qindrue njeriu në këmbë duhet me pasë dëshirë, se ndihma e përkrahja e huej këtu nuk munden me ndërhyrë.

Seicili është i zoti i punëve që kryen, mundet me luftue rrenën e të bëhet i sinqertë, mund të bëhet zemermirë, bujar dhe përkrahes, në qoftë se lufton ashpërsin. Të gjitha varen prej atij; njeriu vetë naltson vehten, d. m. th. vetë bëhet i mirë, i dashun e përdëllimtar, vetë ulet në shkallën më t'ulët e bëhet i keq, e zemërashpër. Ndjenja e detyrës është shtylla e hekurt për njerin e përsosun dhe i ndihmon të mbajë nalt vehten, të shtojë fuqin e të mos ketë frikë prej rrymave të shpeshta, që i ngjajnë në jetë.

Miq e perandorit të shkëlqyshëm roman, Pompeut, i lute-shin që të mos nisesh për në Romë, se jeta e 'tij kishte me qenë në rrezik prej valëve të pamëshirëshme të detit; "është e nevojshme të shkoj, tha, e s'është e nevojshme të rroj „.

Fytyra e shkëlqyeshme e Pompeit kreu detyrën e vet tue mos marrë para sysh valë, erna, rrufë e vetëtima.

E kryemja e detyrës ka qenë e vetmja idë e qytetarit të math, ose më mirë me thënë e themeluesit të shteteve të Bashkueme t'Amerikës, Washington-it, i cili, kur shifte se duhesh bënë diçka, shkonte drejt udhës së mbarë, pa marrë para sysh pengime e rreziqe.

Fytyra e 'tij e shkëlqyeshme, që ndriti e do të ndrisi, nuk donte famë, nuk i pëlqente shpërblimet, porse mendohesh se duhesh bënë diçka e mirë. Po këjo ndjënje e naltë e detyrës fry-

mëzonte generalin e famshëm, Wellington, qi mundi Napoleonin e Math në luftën e pergjakëshme të Waterlooos, sepse ushtarët e 'tij ishin kryekëput të bindun e kishin të rrëjosun në thellsinat e zëmrës ndjënjen e shëjtë të detyrës. Generali i famshëm, tue pamë se kundra 'tij vinte artilleria Françeze, u tha ushtarve të 'tij: "ushtarë, mos u-frikësoni, mendoni vetëm se ç'farë kanë me thënë për ju n'Angli;," dhe ushtarët i u-përgjegjën: "Milord, mos u-trembni, e njoftim detyrën t'onë;".

Asht një gjë e naltë për një shtet qi të jetë i vaditun me ndjenjat e detyrës e, derisa të jetë këjo, nuk ka frikë për t'ardhmen, por, në qoftë se këjo pak nga pak zhduket tue ia lënë vendin luksit dhe famës egoistike, atëhere atij shteti për së shpejti ka me i ardhun prishja.

Mbledhë prej

A. Andriku '33.

Vjerrsha "V a j e,, e Çajupit.

Vjerrsha "V a j e,, e Çajupit është një elegji shumë e bukur e poezis Shqiptare. Në këtë vjerrshë poeti i jonë melankolik çiryn gjithë urrejtjen e vet, që ka për botën. Bota për Çajupin është një vend, që mban në gjinin e vet gjithë rrenat me bisht! Sikur t'ishte i gjallë sot Çajupi e ta pyetshim se ç'është bota, pa dyshim kishte me na u-përgjegjun me nervozitet se është një folë, ku thuren intrigat; është një vend kusarësh, ku, në vend të drejtësisë e të lumnis, zotnon padrejtësija e fatkeqësija.

Poeti pra botën e quën **të pabesë**. Ka arsye që e quën ashtu: ai vjete me radhë ka punue për një ideal, por puna e, 'tij nuk e kënaqte zëmrën e ndezun të poetit; mandej nga çdo anë me bënë dishka: të mirë, ose të keqe, d. m. th. për me mbarue një punë; shifte edhe shpikjet e mbëdhja të zhenis së njeriut, etj. e çdo gjaje donte me i dhënë një shpjegim. P. sh. Pse len njeriu? Pse jeton? Pse e bënë këtë punë për shekuj? E të tjera kësi pyetjesh i bënte velites poeti, por, kur pa se truni i ngushtë i njeriut nuk mundesh kurrsesi me i dhënë ndonjë përgjigje msheftësinave të botës, atëhere, i dëshpëruem fort, zëmra i rënkoj, mendja i mendoi e dora i shkroi:

Botë, moj Bot' e pa-besë.

Nukë ke gjë të vërtetë:

Ja me dy vargje të zbukuruem me fjalë popullore Çajupi

na e kallzon se ç'është bota e se ç'përmban në gjinin e 'saj. nuk i pëlqen të flasí má gjatë, por ndërgjegja nuk e lën të heshti. Ai kërkon me na e çfaqun mendimin má këthjellët, qi të mos i mbetet kujt dyshim, sepse e quen botën të pabesë, prandaj ven dy pika mbas vargut të dytë edhe shton :

Njeriu po do të vdesë
As nuku vjen më në jetë.

Jetën Çajupi e merr si një rrugë, nëpër të cilën njeriu ka me kalue vetëm një herë e mandej s'ka me u-këthye kurrë. Por kjo është një rrugë e shtrueme me ferra edhe e gjatë 50.. 100 vjet udhëtimi. Pra njeriu dërrmohet, punon e shkrin gjithë fuqit e 'tij për me qitun dishka në krye edhe ndoshta mund të bájë ndonji punë, por në fund, . . . ah, . . . në fund ka me vdekun e . . . s'ka me u-këthye kurrë në jetë

. . . . E tashti poeti bëhet profet i vehtes së vet. Me një strof u-mjaftue për me na tregue marrinat e botës edhe mendja mendon për fatin e 'tij :

Do të gdhietë një ditë
Do të vijë një mëngjes
Nukë dotë shoh të mijtë :
Do mbyll sytë, do të vdes !

Ai që din se si ka vdekun Çajupi, ka me kujtue tashti se këto vargje nuk kanë dalun nga mendja e poetit vetë, sepse me shkruie mënyrën e vdekjes përpara se me vdekun, është si mrekulli. Kështu njeriu kujton se Çajupi vetëm i ka shkruie këto vargje e i ka trajtue një njeri t'jetër . . . Një mendje profeti të pa dukun !

Por jo . . . Ndërgjegja e këthjellët e Çajupit e lajmëronte qysh má përpara mënyrën e vdekjes dhe me të vërtetë ashtu si shkroi, ashtu u-bà: u gdhi një ditë edhe larg, shumë larg prej këtu, atje nën rrezet përvëluese të Misirit, Çajupi melankolik, poeti i ynë rustik, mbylli syt për gjithëmonë pa pamë atdheun, që e ka dashun fort dhe pa u-shmallun me t'afërmit e 'tij. A ka profeti má të sigurtë se kjo ?!

Poeti nuk ndalet këtu. Ai shton dishka edhe për mbas vdekjes së 'tij :

Do të qajnë e të vajtojnë,
Do t' më mbulojnë me gurë,

Thotë se t'afërmit e 'tij, kur ka me vdekun, kanë me e

qamë e me e vajtue edhe si nder, për mos me e ngrënë korbat mishia e 'tj, kanë me e kallun kufomën në dhë; por asnji vlerë nuk kanë këto për Çajupin, kur kujton se:

Pastaj dolë më harrojnë

Dhe, sikur s'kam qenë kurrë!

Ja këtu poeti është në kulmin e pesimizmit. S' ka ngushëllim për 'të. I bie lapësi nga dora dhe pa dashun mbyll letrën e bardhë. Jeta është kotësi (vanitas), . . . hiç gjâ, një brimë n'ujë! As miqt, as t'afërmit nuk hykan në punë; . . . është ora më kritike për poetin e, sikur t'i binte n'atë kohë një plumb në zëmër, kishte me ikun prej kësaj bote të pabesë e të rremë pa nxjerrun asnji ah!!

¹⁾ Shënim: Emri i vërtetë është Andon Çako dhe ka lë më 1864 në Sheper të Zagarisë (Gjinokastrë.) Ndërroi jetë më 1930 në Kairo të Misirit. Ka shkruar librën "Baba Tomori", me poezi heroike, erotike dhe satirike, edhe një komedi "Katërmëdhjetë vjeç dhëndër!," Përkëtheu "Lule Hindi" dhe "La Fontaine-i."

St. Spasse '32.

Provë mësimi

dhânun në rendin e I rë t' Ushtrimores.

Landa: Mësim jete, Arithmetikë

Thema: a) Duhâni e damet e 'tj.

b) Zbritje deri më 8.

Z h v i l l i m :

(Mjetë mësimi: duhan gjethe, të grimë, paqeta, vegla të vjetra, si thikë duhani, havan, etj.

Sikurse e dimë, për me ia mbërrimë qëllimit më mirë e për të pasun një përfundim është si duhet, në një mënyrë të lehtë e të pamërzitshme, duhet të ndjekim gjithë ato rregulla, qi na ep pedagogjija.

E pra në këtë lëndë mësimi, përveç rrugëvet të tjera, qi mund të gjejë një mesues, mund të veprojë edhe në këtë mënyrë:

Paragatitja: Në fillim pyeten nxânsit se kush e di prej 'tyne maqinën S. A. I D. E; kështu nxânsit kallzojnë se ku ndodhet kjo maqinë e natyrisht ka me dalun puna ke duhani.

Paraqitja. Mbassi i përçon mesuesi fëmijt aty, ku e ka qëllimin e vet (ke duhani), zë e u paraqit lëndën në këtë mënyrë:

Pyeten nxânsit se ku e merr kjo maqinë duhanin; këtu lihen të kallzojnë vetë ato gjâna, qi dijnë e pastaj më-

suesi do të përflassi bashkë me ata të gjitha punët e duhanit, tue fillue qysh prej të mbjellunit të farës e deri në të bâmunit paqeta, etj. Të gjitha këto gjâna do të përflliten me rradhë e natyrshëm tue i nxitun femit të formojnë fjali të thjeshta e të shkurtëna për gjânat mâ me rândësi, fjali të cilat pastaj thohen edhe horas.

Mbasandaj bisedon mesuesi bashkë me nxânsit për fitimin qi ka **si** bujku, si **shteti** prej duhanit; mâ në fund do të përfllitet edhe për përdorimin, për dâmet qi na sjell duhani në trupin t'onë, tue i tregue **se** ai përmban një helm, i cili vesh zorrët e mushkënit t'ona e për ta kuptue femit mâ mirë ketë gjâ, u bâhet një provë e thjeshtë : ndizet një cingare duhan dhe merret një shami e bardhë; pastaj, tue nxjerrë me një shtërgim prej goje ke shamia tymin, qi kemi thithun, do të shofin ata **me** syt e 'tyne një njollë si të kuqe të murrët; kështu mësuesi u thotë se ky është ai helmi, qi na vesh zorrët po të pimë duhan.

Fellimi e ushtrimi : Permblihet e gjithë lânda në pikat kryesore me fjali të thjeshta, të cilat përsëriten tue u^uthanë veç e veç e horas.

Thema b) Zbritje deri mbë 8.

Paraqitja : Na pra thamë se duhâni bâhesh paqeta, mirpo kush i merrte kto paqeta ? Kiu do të vijë puna ke duhânshitsi, e kështu mesuesi ia nis punës.

Paraqitja e ushtrimi : Për me u-bâmë mësimi mâ konkret e mâ interesant, merr mesuesi disa paqeta gjithëfaresh, si Sopot, Kastriot, Rekord, etj. dhe i vën truma, truma (por tue mos e kalue 8, d. m. th. në një vend 3, 4, 5, 6, . . . 8, etj.) dhe u thotë nx. se do të shesim edhe na nashti paqeta, porsî duhanshitsi. Nxjerr një nxânës i cili rri afër masës, (ku ka tre paqeta) si duhânshitës dhe një t'jetër, të cilin e çon mësuesi tue i thanë, qi të blejë ke ai dy paqeta. Atëhere mësuesi pyet nxânsin se edhe sa paqeta i kanë ngelë pa shitë Nx. 2. Kështu nx. thotë se tre paqeta pa dy paqeta, bâjnë një paqetë (horas).

Po në këtë menyrë do të bâhen edhe ushtrimet e tjera qi shënohen në tabellën e mësimit këtu poshtë së bashku me nx. tue i thanun edhe horas e tue i shkruem mësuesi në derrasë të

zezë e nx. në fletore.

Tabela e mësimit. (b)

| | |
|------------------------|-----------|
| □□□ - □□ = □ | 3 - 2 = 1 |
| □□□□ - □□ = □□ | 4 - 2 = 2 |
| □□□□□ - □□ = □□□ | 5 - 2 = 3 |
| □□□□□□ - □□ = □□□□ | 6 - 2 = 4 |
| □□□□□□□ - □□ = □□□□□ | 7 - 2 = 5 |
| □□□□□□□□ - □□ = □□□□□□ | 8 - 2 = 6 |

Q. Kopani '33.

Provë mësimi

Dhânun në rendin e Itë t' Ushtrimores.

Lânda : Kângë.

Thema : Macja e miu.

Zhvillim.

Për zhvillimin e kësaj theme mës. bân një hyrje tue iu thânë nx. se unë kur po shkoja mbramë në shtëpi, ndigjova dishka qi bante kështu : (mës. bân zânin e borisë) edhe i pyet nx. se ç'do të ketë qenë ajo. Atëherë nx. kanë me u-përgjgjë se ishte burija e ushtarëvet. Nashti mës. i pyet përsëri nx : a e dini ju se përse binte ajo ? (Nx për me fjetun ushtarët).

Kështu mës. ngren një nx. qi të bājë edhe ai si bân burija. Mbassi të bāhet edhe këjo, atëhere mës. u thotë nx: mirpo ne këtu në shkollë kemi mësue disa gjāna të tjera për me këndue zânin e borisë. Atëhere nx. kanë me thānë: notat. Në këtë mēnyrë mës. e qit qëllimin e mësimit edhe ngren një nxānës, qi ta këndojë zânin e borisë me nota (nx. i kanë mësue notat) e kështu e këndojnë edhe të tjerë nx. një nga një, mā në fund edhe horas.

Nashti mës. u thotë nxānësve se ju ditkeni të këndonj shum bukur me nota; kush do t'i shkruiejë në dërrasën e zezë këto nota qi thamë ? (Mës. ngren një nx. edhe vetë bân me të shpejtë një masë; nx. i shkruen notat). Mbassi të bāhet edhe këjo, mës. i urdhnnon nx., që t'i këndojnë një nga një notat e shkrueme në dërrasën e zezë, (edhe horas). Si të jenë bāmë edhe këto, atëhere mës. i pyet nx. se vetëm kaq nota kemi ne? Nx. kanë me u-përgjgjë : jo, Z. mës., kemi 7 nota.

Në këtë mënyrë i thonë nx. të gjitha notat një nga një edhe horas. Mirpo nashti mës., qi të munden nx. t'i kuptojnë mirë notat mbas zânit, që ka siecila (të ngritmet e t'ulmet e zânit), përdor disa shenja dore të veçanta (mimikë). në mënyrë qi, tue e folë nx. notën, të bëjnë edhe shënjen me dorë. Për këtë gjë u mësohen nx. për secilën notë nga një shëjë dore, si p. sh. (ke Do-ja dora rri posht edhe mbasandaj ke Re-ja ngrihet pak, por tue i ndryshue faqet e duervet, e kështu ke Mi-ja pak më nalt si mbas zânit, kështu qi, kur të flitet do-ja e vogël, dora të jetë ngritun për mbi krye.) Këjo gjë bëhet shumë herë prej nx. një nga një edhe horas Në këtë mënyrë bëhen shumë ushtrime, tue fillue prej kreut në fund, por edhe prej fundit në krye, d. m. th. tue fillue prej Do-së se madhe ke Do ja e vogël, por edhe prej Do-së se vogël ke e madhja.

Nashti u thotë mës. se, mbassi ju dini të këndonit shumë bukur me nota, edhe mës. ju ka prurë disa nota, qi t'i këndonit (edhe kështu mës. ka paraqit nx. kangën, qi do t'iu mësojë me anën e notavet, të cilat i ka të shkrueme në një tabelë të përgatitun ç'më përpara edhe e var në dërrasën e zezë). Kështu mës. përpara se t'i këndojnë nx., u thotë se ç'far shofin n'atë tabelë; atëhere nx. kanë me u përgjegjun : një çelës, notat edhe masën e kohës. Si të jetë bëmë edhe këjo, urdhënohen nx. qi t'i këndojnë me radhë një nga një edhe të gjithë së bashku (para se t'i këndojnë nx., mës. i jep zânin e notës së parë ose me zâ ose me violinë) edhe mës. mban kohën. Porse këtu mës., qi të mund të bëjë, qi çdo gjë të dali prej nxânësve vetë, vë edhe një nx., qi ta mbajë kohën edhe të tjerët i këndojnë.

Mbasandaj mës. u thotë se ju i kënduet me gojë e nashti unë do t'i këndoju me violinë edhe fillon. Si mbaron mës., atëhere i pyet nx. ne kemi një kangë kështu, a e dini ju ? (Nx. u kujtohet nashti vjerrsha, qi e kanë pasë mësue më përpara edhe thonë: kënga e macës me miun).

Në këtë mënyrë del qëllimi i mësimit edhe fillohet mësimi i kangës, por, përpara se të bëhet këjo, duhet përsëritun një herë vjerrsha e, në rast se nx. nuk e dinë mirë vjerrshën, atëhere përsëritet disa herë, deri sa ta nxajnë mirë fare edhe mbasandaj fillohet të kënduemit e kangës me anën e notavet, por nashti në vendin e emnavet të notavet fliten fjalët, kështu qi bëhet këndimi i kangës me fjalë.

Herën e parë e merr një herë më. me violinë edhe mba-sandaj u thohet nx., qì t'i venë edhe ata mbrapa. por me zà t'ulët. Mbassi të bàhet edhe këjo dy a tri herë, mà në fund e këndojnë nx. me zà të naltë e. si t'ushtrohet edhe këjo, nxànsit e këndojnë vetë pa ndifmën e më. Po ashtu e këndojnë nxànsit një nga një. e më. u jep zànin e notës së parë.

Mà në fund e këndojnë edhe rrjeshta, rrjeshta gjith ashtu edhe banka, banka e në fund fare e këndojnë të gjith së bashku.

S. Hamiti '33.

Provë mësimi

Dhânun në rendin e III-të t' Ushtrimores.

Landa : Mësim jete

Thema : Prej bërthamës së mollës deri ke molla e pjekme.

Zhvillim

Landa qì do të përpunohet : 1) Si bàhet prej bërthamës pema, tue u kallzue mënyrën e të mbjellunit.

2). Të lanët e mollës të rritet, ashtu, si e mbjellim na ep mollë të egra, prandaj duhet shartue.

3). Duhet të kujdesemi për pemët tue i përdorë mirë.

4). Mollët e tjera pemërina si dhe perime i ruejmë e dhe për dimën.

Paragatitja : Këtu puna shkon shkurt, marrim 1 kokër mollë dhe u a kallzojmë nxànsësvet tue i lamë ata të flasin për pjesët. Mandej mësuesi u-thotë: vini re, ta çajmë këtë mollë dhe të shofim pa le do t'i gjejmë fara mbrenda. Si e çan më. ua tregon farat (bërthamat) dhe ep në çdo bankë nga një farë.

Pataqitja Mës thotë nx. vini re, kush do të më thotë mue pse na duhen ato bërthama ? Si të marri përgjegjen, u thotë ku i mbjellim këto ? Nx. këtu ndoshta do të ngelin. Mës. ua kall zon vetë, se këto i mbjellim në saksí, këtë e përsërisin nja 2 a 3 mandej horas. Me një mënyrë mjeshtarake u thohet dhe për tokën, që do të ketë saksija (ranë).

Mandej përfillet se në ç'kohë mbillen këto (më 15 dhetur). Mës. tash nxierr një saksí dhe ngre një nx. që të mbjelli bërthama, por me një mënyrë që të shohin të gjithë.

Si të mbarohet së mbjelluni, kallzohet tue vetveprue nx.

që saksin' e lemë në një vent të ngrofët 1 muej, deri sa të mbijnë pakë. Mandej gjithnji, tue vepruem edhe nx, me anë të nxiturash, i shkulin i mbjellim në një vent të punuem mirë dhe të jetë vetëm për këto dhe aty i lamë 2 vjet (atij vendi i thomi fildanishte). Mbassi është thanë se aty këto filiza mbillen afër, u thohet a munt të bëhen? Nx. natyrisht do të gjykojnë se jo.

E pra vjen vetvetiu puna se u-dashkën shkulë këto që prej këndej dhe i çojmë në një vent t'jetër, që edhe këtu të jetë toka e punueme. U thohet se, po t'i lemë këto që të rriten, për sa kohë munt të na apin kokra! (Nx. . . .) Mës. për 7-8 vjet. Pastaj u-pyeten nx. se çfarë kokra molle do na apin këto pemë molle? Tue i nxitë Nx. do vijë puna qi të thonë se më par kokra të këqija e mandej këtyne pemëve në u thomi t'egra. (thohet horas). Si merr funt kjo u thomi nx. se çar folëm deri tash në bazë të përgjigjes. Mës. u thotë dhe shkruan në dërrasë "Si mbillet bërthama e mollës që na ep pemë? .."

Mandej u thotë mës. se këto pemë nuk janë të mira, se na apin kokra të liga, pra çfar të bëjmë ne që t'i bëjmë të buta e të marrim kokra të mira? Me nxitjen e mës. do thonë t'i shartojmë. Flitet pakë mbi shartimet, dhe mandej pyeten përse folëm Mës. shkruen në dërrasë "shartimi i pemës s'egër.

Flitet mandej për shërbimin që duhet t'i bajë ai që merret me rritjen e pemëve, se pemët atë kanë si bábë e nanë, pra duhet kujdes.

Dhe mbi këtë shkruhet një shkurtim në dërrasë. Mësuesi u-thotë kur piqen mollët, ata thonë në stinën e vjeshtës. Mës. u-thotë se ne vetëm në vjeshtë hamë mollë? Nx. jo, ruejmë edhe për dimën. Kështu mës. bashkë me nx. flasin se si i ruejnë, jo vetëm mollët, por edhe fiqt, damate, bamje e tje. tue u-kallzuem dhe si i ruejnë.

Dhe mbi këtë bëhet një shkurtim.

Përmbledhja. Nja 4, 5 minuta si të marrë funt osa bëhet një përmbledhje në bazët atyne pikava. që janë shkruem në dërrasë, e më në funt u thohet nx: shkrueni në radhë këto, që ka shkruet mësuesi, dhe i plotsoni në shtëpi.

T a b e l l a

- I. Si mbillet prej bërthamës molla, që bëhet pemë.
- II. Shartimi i pemës s'egër.
- III. Si duhet t'i këqyrim dhe t'i përdorim pemët.
- IV. Si i ruejmë kokrrat e pemve dhe të zarzavateve.

A, Selenica '33.

Provë mësimi

Dhânun në rendin e V të t' Ushtrimores

Landa : Dituni Natyre.

Thema. Krypa.

Nji hyrje të shkurtër, por të mirë, bân mësuesi për këte mësım, tue bisedue së bashku me nxânësit për ato gjâna, qi kanë mësue mbi prefekturën e Durrsit, kështu qi të nxiten; ndër ato natyrisht do të zihet me gojë edhe krypa.

Paraqitja. Në të biseduëm e sipër del se krypa bâhet mâ tepër në Kavajë e pak në Vlorë, e kështu i pyet mësuesi nxânësit, qi të gjejnë shkakun e ksaj gjaje. Kështu del fjalija se **krypa bâhet prej ujit të detit, mbassi ky âsht i shëllinshëm.** (këtë fjali të gjatë e thonë disa nx. e pastaj të gjithë).

Po i kallzon mësonjësi, ujët e detit ka krypë të shkrime brënda afër 20 gr për 1 l. uj deti, ose si të themi mâ lehtë nja nji grusht krype. Mirpo si âsht kjo punë e çuditëshme kështu që ujët e detit të kthehet e të bahet krypë?

Me ketë pyetje fillojnë nxânësit me gjykue se si mundet me ndodhë kjo gjâ, tue ç'faqun mendimet e 'tyne; në këtë kohe mësuesi u bân nxânësvet disa prova të thjeshta e praktike, të cilat i kanë pamë edhe në shtëpi, merr nji enë me uj, i shtije edhe krypë brenda tue e përzimë mirë e mirë deri sa të tretet, d. m. th. bân shëllinë, tue i kallzuem nx. se edhe ujt e detit po kështu âsht. Pastaj pyeten fëmijt se si e regjim djathin në shtëpi, si e shtimë, si i regjim specat, pse i a fusim shëllinën, etje; kur bahet prova pyeten nx. se ç'u bâ krypa qi shtimë mbrenda enës, e kështu del puna vetvetiu **qi krypa shkrihet mbrenda n'ujë.** Mësuesi. Ju ndoshta i kini vumë mendë në shtëpi ndonje qypi me djath a me specat të regjun. Kur të mbarohen këto, në fund të qypit ngel nji si shtresë e bardhë. . . qi po ta piqni në gjuhë ka nji shie të veçantë. Nx. Oh! zoti mësues, ajo âsht shtresa e krypës. Mësuesi. Mirë po si âsht kjo punë kështu kurse ne e shkrimë krypën n'ujë dhe e bâmë shëllinë ?Këtu lihen nx. në nji shkallë që të thonë, se ujët gjatë kohës u-avullue e ngeli vetëm krypa. Me të vërtetë u flet mësuesi, por mendoni ndashti se ç'mund të ngjajë edhe me ujt e detit?

Sikur t'u pyeste juve rrugës ndonji katundar i shkretë, qi nuk dinte se si bahet krypa si kishit me i u përgjegjë? E dhe

nx. të shtymun e të udhëhequn aty, këtu edhe prej mësuesit, kallzojnë me fjalë të thjeshta mendimet e 'tyne. Krypa bëhet prej ujit të detit, nëpër tokat që janë buzë detit e në një rafshë me atë. Në këto toka çilen gropa të mëdhaja, të cilat janë shtrur me çimento.

Këto gropa mbushen me uj deti. që futet me anë të kanalëve e të rremavet, të cilat mbasandaj mbyllen, për të mos u-futur më uj nëpër gropat, deri sa të avullohen e të thahen shtresat e ujit të përparshëm (Në këte kohë mësuesi bën një skicë të mirë kryporeje në dërasën e zezë.) Mbasandaj nxiret nga nxânësit se këtyne gropave kështu u them **krypore**, pse këtu bëhet krypa (krahasohet kryporja me shelqen a kryporen e shtëpis e ndryshimi qi kanë).

Mbassi të jenë mbushë këto gropa me uj deti dhe ti lëmë për një kohë të gjatë në diell, ç'farë do të ndodhi në këtë kohë? Nx. ujt nëpër gropa avullohet pak nga pak e më në fundi ngel një kore (shtresë) e trashë prej krype, pors korja e bukës

Mbasandaj nx. kallzojnë se si ndodhi kjo: si u-avulluë ujt e si ngeli, krypa, qi qe e shkrime në fund.

Kur shofim korën e krypës, diçka na bije në sy më tepër... Lihen nx. qi të rëfejnë se duken disa thërmija të vogla, pors thërimet e sheqerit. Ato shkëlqejnë në dritën e diellit. Kur nx. nuk munden me e gjetun, atëhere u kallzon mësuesi se ato quhen **kristale** (e thonë nx. një nga një edhe horas e pastaj shkruhet në dërrasë të zezë). Shëkon pra. ujt e detit, kur avullohet paska një veçori se krypa e shkrime mbrenda n'ujë merr formën e **kristalevet kubike** Kështu edhe nx. nxiten të thonë se veçorija, qi ka ujt e detit, kur avullohet të kthehet në kristale, **quhet kristalizm' i ujit të detit** (horas).

Mbassi të jetë kthye pra në kristale kubike e si të jetë thamë, atje e lënë njerzija atë pastaj? Këtu nashti del puna të mbledhunit e të bájunit e krypës; punëtorët e mbështjellin me lopata edhe e bájne truma, truma, pastaj e fusin nëpër thasë dhe e ngarkojnë nëpër automobilat për ta shitë. U-thohet nx. pale a u kanë vumë re atyne automobilave, qi bájne e bijnë krypë, se ç'farë kanë të shkruem përpara a nëpër anët. Ata kanë pamë se këndojnë S. I. T. A. por nuk dijnë se çdon me thënë. Atëhere Mës. u thotë se kjo shoqni ka marë për sipër të nxjerunit e të shitunit të krypës, të cilën ia ka shtitë

shteti. Pyeten Nx. qi të kallzojnë se vetëm Sita e ka në dorë këtë punë e s'ka të drejtë kurkush, sikurse janë edhe shumë gjëna të tjera, qi blihen prej Shtetit nga shoqërit e ndryshme si shkrepstat, letrat etj., d. m. th. gjëna qi shiten vetëm prej nji njeriu: atëhere themi se është **monopol' i shtetit**.

Mbasandaj pyeten se ku shitet krypa këtu ke na, çka këndon në tabelën: "**Axhensija e krypës Elbasun.**„

Po nuk e ditën, spjegohet fjala axhensija prej **mës.**, tue u thënë se është nji degë e shoqnis, sikurse axhensija e automobilave, biçikletave etj. Për t'u-bâ mësim edhe mâ konkret, u-shpërndalet nga pak shkruajn krypë secilit **nx.** tue i thënë qi t'a shikojnë me kujdes ta prekin e ta shijojnë. Natyrisht fëmijvet do t'u bjeri ndër sy edhe ngjyra; është krypë e zezë; mësuesi kërkon prej 'tyne d. m. th. të kallzojnë se, kur është mbledhë krypa, është përzimë me pluhna e me dhe; por na kemi krypë të bardhë; ajo është përzime me pluhna e me dhe; por na kemi krypë të bardhë; ajo është bâmë mâ me kujdes nëpër gropa të pastra. Në këtë kohë i provon **mës.** në se edhe krypën e zezë, po ta pastrojmë, d. m. th. po ta **lajmë, bâhet bardhë.**

Mës. Por kemi edhe nji lloj krype t'jetër, qi është e bardhë prej vetiu, porsî sheqeri: Edhe nx. zanë nëpër gojen krypën e gurit, të cilën, kur nuk e dinë nx. se si është bâmë, ua tregon mësuesi: n'ato vende ku gjindet krypa e gurit, kanë qenë dikur dete; kto me kohë janë rëxue malet e kanë mbulue dette. Tue kalue me mijra vjete, uji e detit, si e dimë, është avullue, e ka ngelë vetëm krypa, e cila, nën peshën e rëndë të tokës, është ngjeshë e forcue porsî shkambi.

Flitet pastaj se si shkojnë dhit e dhent mbas ujnave të burimevet e gjëjnë shqembe krype; gjithashtu u spjegohet edhe si e qysh i nxjerrin këto nga dheu me maqina.

E, mbassi të jenë përfolë këto të gjitha, i pyet mësuesi nx. se ç'farë rëndësije ka krypa për ne, kështu qi të mendojnë ata se sa të shijshme do t'ishin ushqimet si për ne ashtu edhe për kafshët si edhe për shtetin qi nxier.

Në këtë kohë mës. u-kallzon edhe nji përrallë të vogël për randësin e krypës, se i nxit edhe interesin:

Nji herë moti nji mbret kishte tri goca. Mirpo ai mbas disa kohësh ra sëmundë shumë keq, saqi s'kishte shpresë të

shpëtonte e për këtë shkak thiri tri vajzat e veta në kohën e shpirtit, tue i thanë se fronin e mbretëris do t'ia linte asaj goce, qi do ta shfaqte mâ mirë mbi babën e 'saj. E madhja edhe mesmja i thanë se eduan sa syt e ballit; por vajza e vogël nuk i tha gja tjetër veçse këto fjalë: " O babë, unë të dua sa krypa,, I ati në fillim u-dëshpërue, pse të deshirohesh aqë poshtë, mirpo, kur zû e ia spiegoi goca e vogël se e donte sa krypa, d. m. th. jeta pa atë s'i kishte shije, nuk mund të ronte pa atë, atëhere ai u-çudit për mendjen e hollë të bijës së vogël, të cilën, tue e rrokë në qafët për herën e fundit, e lã trashigimtaren e fronit.

Më në fund bisedohet me nx. se krypa duhet të përdoret me masë, as mâ shumë, as mâ pak, se për ndryshe prishen gjellët etj.

Zihen me gojë disa fjalë t'urta prej ms, si për shembull: **gjella me krypë e krypa me karar.**

Spiegohet domethanja e drejtë dhe e figurëshme e 'saj si p. sh. të mos flasin kot, të mos çojmë kohën kot, por çdo gjã me karar e me rregull.

Tabella e mësimet

Krypa:

Si bâhet krypa?

Veçoria e krypës, (kristalizimi)

Ç'rëndësi ka krypa për në

Sa lloj krypash kemi.

Masa në të përdorun.

Provë mësimi

Dhânun në kl. IV të shkollës Ushtrimore.

Lânda : Arithmetikë.

Thema : a) Pjesëtimi i nji numrit të dhjetshëm me 10, 100, 1000 e me 10000

b) Pjestimi i numrit të dhjetshëm me nji numër të tânë

Zhvillim

Hyrja: Mësuesi: kush do të më thotë mue disa nga gjânat e ushqimit, qi blejmë në pazar? Nx. numrojnë disa nga ato gjâna si oris, sheqor, krypë, patate, frashull, etj. Mës.: ç'gjellë

bâjmë me oris? Nx. ja Z. mës. pilaf; i shtijmë krypë, tylënë. Mës. sa lekë kushton një kg. tylën? Nx. mund të thonë 11 ose. 12 lekë, por mësuesi u thotë se tylini tashti kushton nga 10 lekë kg.

Mës. një katundar ditën e pazarit kishte prurë 13,5 kg. tylën dhe e shiti nga 10 lekë kg; kush do të më thotë mue se sa lekë ka marrë katundari? Njëqoftë se nx. këtë problemë e bënë me mend, atëherë mësuesi ngren edhe një nx., qi ta bëjë në dërrasën e zezë.

Si ta kenë mbaruem nxânësit, mësuesi i thotë: sa lekë do të marrë katundari? Nx. katundari do të marrë 135 lekë. Mës. pra. kur shumëzohet një numër me 10, pikën dhjetore nga e çojmë? Nx. kur shumëzohet një numër me 10 pikën dhjetore e çojmë nga krahu i djathtë një shifër. Këtë e thonë disa nxânës veç e veç, pastaj e thonë edhe horas. Po në këtë mënyrë bëjnë edhe në shumëzimin me 100, 1000 etj., tue iu thënë nxânësve se pikën dhjetore e çojmë nga e djathta aqë shifra sa zero qi të këtë shumëzuesi.

Mës. ju dini të shumëzoni me 10, 100, 1000, etj., po sot do të mësojmë se si mund të pjesëtojmë me 10, 100, 1000, etj. Mës. u thotë nxânësve një problemë. p. sh. 75.5 kg. misër do t'i marrin 10 veta; sa kg do të marrë çdo njëri? Mbassi nx. nuk mund ta bëjnë, mës. u thotë: po ta shumëzohet me 10, pikën dhjetore nga e çojmë? Nx. e çojmë nga ana e djathtë. Mës. po tani qi e pjesëtojmë, nga do ta çojmë? Mbassi nx. nuk e dinë ua thotë mësuesi: kur pjesëtojmë me 10 pikën dhjetore e çojmë një shifër nga krahu i majt. Në këtë mënyrë mësuesi bën problemën $75.5 : 10 = 7.55$. Mës. për t'ua vërtetuem nxânësve, se pse del kështu, e pjesëton 75.5 drejtpërsëdrejti me 10. Po në këtë mënyrë bëhen shumë ushtrime tue pjesëtuem me 10. Si ta kenë mësue mirë këtë, mësuesi u thotë problema të tjera, qi t'i pjesëtojnë me 100, 1000, etj. Mbassi të jenë ushtrime nxânësit mirë në këta pjesëtime, mësuesi u thotë nx. ç'e bëjmë pikën dhjetore, kur pjesëtojmë me 10, 100, 1000 etj.? Në qoftë se nx. nuk e thonë drejtë, ua thotë mës. ose i drejton nxânësit me një pyetje, qi ta gjejnë vetë; mbasanlaj thonë se pikën dhjetore e çojmë nga ana e majtë aqë shifra sa zero qi të këtë pjesëtojsi. Në këtë mënyrë mësuesi u bën edhe ushtrime me mend.

Mës. si ta shofi se nx. e kanë mësue mirë pjesëtimin me 10, 100, 1000, etj., u mëson edhe pjesëtimin e një numurit të

dhetshëm me një të tănë. Mës. dhe në këtë rast u thotë nx. problema të lehta, qi mund t'i bëjnë p sh. 53. 21 kg. grunë do t'ua ndajnë 5 vetve Kush do të më thotë mue sa kg. do të marrim secili prej tyre? Mbassi nx. as këtë mënyrë pjesimi nuk e dinë, fillon e e bën vetë mësuesi. tue pjesëtuem 53'21 me 5 në këtë mënyrë: Mës. pesa ke pesa sa herë hynë? Nx. një herë Mës. cilën do të zbresim njëme? Nx. 3 Mës po 5 ke 3 sa herë hynë? Nx. këtu s'hynë, Z. mës: Mës. pse? Nx. se 3 është më i vogël se 5. Mës po sa herë do ta shënojmë në këtë Nx. zero Mës. po sa mbeten? Nx. 3 njësha Mës. po tashti cilën do të zbresim? Nx. 3 njësha Mës po tashti cilën do të zbresem? Nx. do të zbresim 2. Mës. po ky 2. ç'është? Në qoftë se nuk e dinë nx. ta thonë vetë, u thotë mësuesi: në cilën anë të pikës dhetore është 2? Nx. është nga ana e djathtë e pikës dhetore. Mës. po si u thomi atyne numrave, qi janë nga ana e djathtë e pikës dhetore? Nx. u thomi numra dhetorë. Mës. po 2 ç'numur është? Nx. është një numur dhetor. Mës. 3 dhetshe dhe 2 njësha sa bëjnë? Nx. bëjnë 32 njësha. Mës. tek 32 sa dhetsha kemi? Nx. kemi 3 dhetshe. Mës. po, njësha? Nx. kemi 2 njësha. Mës. 5 ke 32 dhetshet sa hyn? Nx. 6 herë. Nx. bëjnë shumëzimin dhe e zbresin 30 nga 32. Mës. ç'i thomi këtij numrit qi pjesëtojmë Nx. i thomi një numër dhetor. Mës. po kur pjesëtojmë një numër dhetor. ç' bëjmë ke herësi? Nx. vëmë pikën dhetore. Mës. ku do ta vëmë pikën dhetore? Nx. do ta vëmë mbas 10. mbassi i zbresin, mësuesi u thotë: po 2, qi mbeti. ç'është? Nx. është 2 të dhetta. Mës. po tashti ç'bëjmë? Nx. zbresim dhe 1. Mës. po 1 ç'është? Nx. është 1 e qintta. Mës. 2 të dhetta dhe një e qindta sa bëjnë? Nx. bëjnë 21 të qindta. Mës. ke 21 se dhetsha kemi? Nx. kemi 2 dhetshe. Mës. 5 ke 2 dhetshet sa herë hynë? Nx. Na 4 herë. Mës. i pyet edhe pse hynë 4 herë. mandej e gjen nx. se 4 herë 5 bëjnë 20 dhe e zbret nga 21. Mës. sa mbetën? Nx. mbeti dhe 1. Mës. po kësaj ç'i bëjmë? Nx. i shtojmë edhe një zero mbrapa. Mës. po sa u-bâ? Nx. u-bâ 10. Mës. po ç'farë 10. Nx. 10 të mijta. Mës. pse? Nx. pse ke dhita kemi dy 5. Po në këtë mënyrë bëhen edhe ushtrime të tjera tue pjesëtuem me 6, 7, 4, 8, 9 etj.

Tabella

13'5 X 10 = 125

75'5 : 10 = 7'55

72'621 X 100 = 7262'1

83'42 : 10 = 8'342

| | |
|-----------------------|-----------------------|
| 9'221 X 1000 = 9221 | 94 : 10 = 9'4 |
| 234'62 : 100 = 2 3462 | 0'92 : 10 = 0'092 |
| 44'3 : 100 = 4'613 | 655'8 : 1000 = 0'6558 |
| 13'55 : 100 = 0'1355 | 132'4 : 1000 = 0'1324 |
| 53'21 : 5 = 10'642 | |
| 6 712 : 4 = 1'653 | |
| 212'4 : 6 = 35'4 | |
| 324'87 ; 7 = 46'41 | |

A. Hajnaj '33.

Provë mësimi

Dhânë në rendin e IVtë t'Ushtrimores

Landa : Gjuhë

Thema : Hartim i përbashkët për "Kavajën".

Paragatitja. — Qi të bëhet mësimi interesant e i kuptueshëm, duhet qi parafytyrimet e reja, qi do të mësohen rishtas, mos të hyjnë në shpirtin e fëmijës si të hueja, por të bashkohen e të njazohen me parafytyrimet e përparshëme. Këtu, mbassi është bā mā përpara mësimit atdhenjohtësie për Kavajën, paragatitja edhe qëllimi bāhen te dyja së bashku tue iu thënë nxânësve se na kemi folë mā përpara mjaft gjāna për Kavajën; pra, për mos me i harruem këto, ç'farë duhet të bëjmë? Nx. na këto gjāna duhet t'i shkruejmë. Në këtë mënyrë nxân. e gjejnë vetë qëllimin edhe sjellin ndër mend ato, qi janë folun mā përpara. Mës. Me të vërtetë na këto gjāna, qi do të përsërisim edhe një herë për Kavajën, do t'i shkruejmë, prandaj kini kujdes, qi t'i mbani mend edhe t'i shkrueni bukur në rradhojt e hartimit.

Paraqitja. — Mësuesi nashti, me anën e pyetjeve të përshtatuna, qit prej nxânësve fjalit, të cilat do të hyjnë në punë për formimin e hartimit. Këto fjali duhet të zgjidhen të mira nga pikëpamja e gjuhës e t'i përshtaten fuqis mendore të nxânësve. Mbassi të qitet secila fjali, nga ana e nxânësve me ndihmën e mësuesit, përsëritet prej disa nxânësve, mandej edhe horas prej të gjithë klasës; mësuesi këtu duhet të ketë kujdes të math, që t'i ndreqi gabimet, qi mund të bëjnë nxânësit.

Fjalit mund të nxirren në këtë mënyrë :

Mës. Ç'farë është Kavaja? Nx. Kavaja është një qytet i Durrsit.
Kjo fjali thohet prej disa nxânësve, mandej edhe horas.

Mës. Ku shtrihet kjo? Nx. Kjo shtrihet në një fushë të gjënë. Mës. Me çfarë rrethohet kjo fushë së largu? Nx. Kjo fushë rrethohet së largu me kodra të vogla. Mës: Na këto fjalë duem t'i bëjmë një fjalë e të mos përsërisim gjithnjë fjalën **kjo**; pra kush prej jush mund t'i bashkojë? Nx. Kjo shtrihet në një fushë të gjënë, që rrethohet së largu me kodra të vogla. Kjo fjalë pra thohet prej disa nxënësve, mandej edhe horas.

Pra fjalit e gjata thohet pjesa, pjesa prej nxënësve, sikurse u-bâ më sipër. mandej bashkohen në një fjalë edhe përsëriten prej disa nxënësve, mandej bëhen edhe horas.

Mbassi të jenë qitë të gjitha fjalit, që duhen për formimin e hartimit, atëherë urdhënohen nx. të nxjerrin bojën e penat. Mës. Çfarë do të shkruejmë në fillim? Nx. Në fillim do të shkruejmë fjalën "Hartim, „ më poshtë edhe datën. Mës. Titullin qysh do t'ia vemë? Nx. Titullin do t'ia vemë "Kavaja „.

Tashti urdhërohen nxënsit të shkruajnë ato, që folëm deri tash e mësuesi shkon sa andej e kendej që t'i verejë nxënsit, që të punojnë të gjithë. Të kujdeset edhe për qindresën e 'tyne, kur shkruajnë.

Tabella e mësimit

H a r t i m

D a t a

K A V A J A

Kavaja është një qytet i Durrësit. Kjo shtrihet në një fushë të gjënë, që rrethohet së largu me kodra të vogla. Fusha e kësaj është mjaft pjellore edhe qit më tepër grun, misër, elb, tërshinë, thekën, etj; pjesa më e madhe e kësaj është e mbuluar me me kullosa.

Kavaja ka 6500 banorë, muhamedanë e të krishtenë; ka dy shkolla fillore, një shkollë buqësije edhe një kolezh-gocash, ka edhe një kishë e disa xhamija.

Kjo ka një klimë të shëndetëshme, pse e rref era e detit. Nëpër buzat e detit të 'saj gjinden kryporet, prej të cilave qitet krypa.

Kavaja bën një tregëti të madhe; kjo qit përjashta krypë, djath, lesh, lëkura, grun, misër, elb, etj.

Fane Skufi '33.

Provë mesimi

Dhânun në rendin e Vtë të shkollës Ushtrimore.

Landa : Histori

Thema : **Normandët.**

Si hyrje për këtë mësim pyet mësuesi nxânësit, qi të thonë disa nga popujt barbarë, të cilët shkelën Shqipnin e për të cilët ata kanë mësue në mësimin e m'aparshëm, e nga copa e këndimit " **Barbarët ne Shqipni** „ Në të kallzuem e sipër, zihen me gojë nga ana e nx. edhe **Normandët.** Sot pra, u thotë mësuesi, do të flasim për **Normandët.** (Kjo fjalë shkruhet në dërrasën e zezë e thohet horas prej nx.). Ms. Me të vërtetë, një nga ata popuj barbarë e t'egër, qi shkelën e dhunuen vendin t'onë, kanë qenë edhe **Normandët.** Këta ishin një popull barbar e i egër prej fisit gjerman, e na këta i kemi ndigjue qysh në të pestin shekull. Këta kishin edhe një kryetarin e 'tyne, qi quhesh **Robert Guiskardi.** Ky pushtoi disa pjesa t'Italis Jugore bashkë me Napolin e kështu u-bâ fqij me ne. E, tue ndigjue se vendi i ynë ashti i pasun, i hyni lakmija e ia drejtoi sytë një qyteti në bregun e detit t'onë, i cili atëhere kishte një nam të math. Ndoshta ju e dini se kush do të ketë qenë aj qytet. . . . Nx. **Durrësi.** Mës. Po pra ata u-munduen me të math me shti në dorë Durrësin, i cili gjindesh nën një shtëpi shqiptare, nën **Shtëpin e Topijvet.** qi përfshinte gjithë Shqipnin e Mesme. Mirpo si jua rrok mendja juve, se i kanë lënë Shqiptarët të shkelin vendin e 'tyne?(nx . . .) Në këtë kohë duhet t'u b'ajmë të njoftun nx. se **Guiskardi** nuk mundi me e shkelun atë qytet as me pare, as me luftë, as me të mirë, as me të keq, por vetëm me hile e me dredhi, të cilën Shqiptarët pastaj e lanë me gjak. Mbassi fëmit e kanë pamë në theatër **Karl Topinë,** atehere i pyet mësuesi qi të kallzojnë ç'kanë pa e ç'kanë kuptue e kështu zë e bisedon bashkë me nxânësit për **shtëpin e Topijvet:** krushqija qi b'ani **Roberti** me Tanush Topinë, princin e Shqipnis së Mesme, tue i dhanë për grue gocën e vet të birit të **Tanush Topis,** me qëllim qi ta gabojë për t'i marrë **Durrësin;** si i vrau dhanduerët, të bijën e vet e të birin e **Topis,** kur i thiri për gosti në Napël, nga shkaku se nuk e kreu qëllimin e vet; shpëtimi i dy djemëve të vegjël të 'tyne, **Karli e Gjoni;** si u-b'ambret **Karli** dhe muer gjakun e t'et tue vramë **Robert Guis-**

kardin.

Mandej u thotë mësuesi se nga këta nuk vuejti vetëm Durrësi, por të thuesh e gjithë Shqipnija e mesme, sepse hyjshin me anijet e 'tyne të lehta në gojnat e lumejvet dhe plaçkitshin ç'të gijshin e, sikur t'u kundërshtojë të të vritshin fare. Shifni pra sa popull barbar ka qenë ky, e sa ka vuejtun Shqipnija e jonë prej 'tyne; por me gjith atë gjyshnit t'anë, u bënë ball pakë së paku e, nuk i lënë të shkelshin gjith atdheun e 'tyne.

Mirëpo, shikoni këtu u thotë mësuesi, ne folëm më përpara se **Robert Guiskardi** erdhi e pushtoi disa pjesa t'Italis Jugore, d. m. th. **Normandët** paskan pasë ardhun prej një vendi tjetër. U thohet nx, tue e shënue edhe në hartën, se **Normandët** më përpsra gjindeshin nëpër gjithë buzët e detit Balltik. Këtu duhet t'i lëmë nx. të thonë se ç'farë shtetesh janë nashti n'ato vende, kështu qi të kuptojnë se **Danlmarkasit, Norvegjzët e Suedezët** janë stërnipnit e 'tyne. Mbassi ata rrojshin nëpër brigjet e detit, me ç'farë do të jenë marrë më tepër? Natyrisht nx. do të përgjigjen: **me vozitari.**

Po, u thotë mës. ata kanë qenë vozitarë të mirë, këta çdo vent, qi dojshin me e grabitë, i turrëshin me anijet e 'tyne edhe si e shkretojshin. kthehëshin prapë në vendet e 'tyne.

Tue u kallzue largësin e Balltikut prej brigjeve të detit Adriatik u thotë: shikoni një herë sa lark qi është Balltiku prej nesh e mendoni se si kanë ardhë ata këtu e ç'ishte shkaku...

Këtu lypset t'i nxisim nx. të kuptojnë se n'atë kohë bije të shpërngulunit e popujvet barbarë e një nga këta qenë edhe ke **Normandët**. Këta shpërngulëshin edhe më lehtë me anijet e 'tyne të shpejta.

Mës. Kush do të më thotë se kush ka qenë n'atë kohë një qytet me nam të math? Nx.: **Roma**. Mës.: Po këtë, si thoni ju, a e kanë lënë pa e plaçkitun Normandët? Jo se ata, kur ndigjojshin e brimojshin ndonji qytet të pasun, i turrëshin me të shpejtë për ta grabitun. Mës. Në këtë kohë ata kishin një kryetar, qi quhesh **Hastings**, bashkë me të cilën u-nisën të shkelin **Romën**. Mirpo, mbassi ky nuk i dinte mirë udhët, në vent qi të shkojë në **Romë**, shkoi në një qytet tjetër, në **Luna**, i cili gjindesh në veri të 'sajë.

Këtu tregohet dredhija, qi bëni **Hastingsi** për të pushtue **Lunan**: si u-bà i krishten, si hapi lajmin se vdiq e se donte

ta shtijshin në kishën e **Lunas**; ngjallja e 'tj në kishë e mizo-
rinat e mëdha, qi bani aty e brenda në qytet. Pas kësajë u thotë
mësuesi, se një kryetar t'jetër i tyne, **Rollos**, shkoi në Francë
e atje pushtoi njëjt vende.

Këtu lihen nx. të gjykojnë se ç'farë mund të kenë bā ata
në Francë: plaçkitjen e tmerimin e popullsis. Nj' aqë fort u-
tremb Franca prej 'tyne se mos pushtonte të gjithë vendin, sa
qi u-shtrënguen t'u falj disa toka n'anë të V. P. e **Rollos**-i
mblodhi atëhere njerëzit e vet e shkoi me ndejtun atje.

A e keni ndigjue ju ndonji herë **Normandin e Francës** ?
Nx. bāhen t'a kuptojnë se **Normandia** ka marë emrin prej 'tyne.

Pastaj flitet për **Rollos-in** se ishte një njeri shumë i egër,
saqi e kishin frikë gjithë **Normandët**, kështu qi ata u-zbutën
e u-bānë të **krishtenë** prej Francezëve. Përveç këtyne, u thotë
mësuesi, këta tash u-mbështuellën të gjithë nëpër vendet e 'tyne.

Nji nga këta, qi quhesh **Rurik**, shkoi në **Rusi** dhe formoi
shtetin e **Rusëve**.

Mā në fund bāhet fund e krye një përsëritje e një për-
mbledhje e shkurtën e, si të mbarohet edhe kjo, urdhënohen
nx. të nxjerin fletoret e historis: ua dikton mësuesi gjithë më-
simin, që në fillim deri në mbarim shkurt e shkurt e gjanat mā
me rāndësi, në mënyrë qi nxānesit tā këndojnë edhe vetë në
shtëpi.

Kjo munt të bāhet edhe tue bā një skicë në dërrasën e
zezë e mandej ta shkruiejnë nx në fletoret, por kjo e fundit
është shumë e thatë, e është frikë se nx. mos ta harrojnë.

E. Selenica '33.

Vdekjet

Më 29-XII-932 ndërroi jetë Bajram Bica '31 nga Peqini.
"Normalistit", i u-shkëput nga gjini një filizë. I njeri. Kush
e din me sa shpresa qe mbushë Zërra e 'tj, kur mbaroi shko-
llën; por, qe, vdekja, qi s'harron njeri, e këputi. "Normalisti",
ngushullon familjen e t'afërmit e 'tj.

Më 9. I. 933 ndërroi jetë Sulejman Goci '29 nga Krueja.
I shkreti; vjet dha dhe provimet e stazhit e tamam në këtë ko-
hë, kur atdheu priste punën e nevojshme prej 'tj, u-nda tue
lanë të shkretë familjen e të dashtunit. "Normalisti", ndien

idhnin më të madhe e ngushullon familjen e t'afërmit e 'tij.

Më 7-II-33 ndërroi jetë Shaban Stafhasani nga Burgajeti i Matit, në mësues në Fulqet (Mat), një arsimtar i ri, i cili me plot zell ia kishte nisë punës së shëjtë. Por vdekja mizore, që ka lanë sa punë mangut, ia rrëmbeu atdheut, taman kur po çilte fletët, dhe këtë lule. "Normalisti", ndien një idhni të pashoqe e ngushullon familjen e t'afërmit e 'tij.

Bashkëpunimi

Më ra në dorë numri i parë i së përkohëshmes "Normalisti". U-gëzova, kur e pash, jo për t'jetër, por tue menduë se një botim i dalun nga duërrët e disa studentave mbushi të pesë vjetët e jetës.

Tue ndië këtë gëzim shoku, me të cilin po flisja, më tha: t'erdhi mirë që e pe të ridalun këtë rivistë pedagogjike, po a i di mundimet që hekin botuesit e saj? . . . I pyëtun nga unë, filloi me mi treguë gjatë e gjënë, mbassi atij i kishte qëllue me i pa tue çfaqë teatra e koncerte për ndihmën materjale. Por edhe për lëndën, që i duhet kësaj, ai më tregoi mundimet, që bëjnë këta djem për ngjeshjen e brumit të së përkohëshmes.

Themën e këtij bisedimi dëshiroj t'ua kallzoj në të vërtetë edhe juve, o të ndershëm këndues, o të dashtun arsimtarë për me ju dhanë disa njohni për mundimin e këtyne nxënësve, në veprën e të cilëve, po ta shqyrtojmë vërtetë ashu si duhet, do të gjejmë bula djerse të cilat në me mjetet që kemi, duhet t'i terim pak, në mënyrë që të mos i ligshtojmë shumë trupat e këtyne filizavet të njoma.

Ndihmën, që raundemi me u dhanë, seicili e ka në dorë; kjo për sa i përket ndihmës lëndore. Por edhe për lëndë, që do kjo rivistë, ndër në mësuesët ka shumë që shkruajnë mirë dhe përshtatshëm për çdo themë; për këtë jam i sigurtë. Vetëm një është që na bën të hiqemi larg nga sfera e kësaj riviste: është egoizma, që mund të ruhet e mbështetur nën hijen e disave prej nesh. Kjo më duket se nuk duhet të zëjë vend ndërmjet edukësve, qofshin Normalistë, Gjinnazistë a po të tjerë.

Në këtë të përkohëshme mund të shkrujë çdo njeri e për çdo themë pedagogjike, kulturele a shkencore që të dojë.

Në këtë mund të shkruiejnë mirë dhe me përfundim të pëlqyeshëm Normalistet për thema: qeverim shtëpije, qi përmbanë programi i shkollave fillore për vajzat; kështu edhe artikuj të tjerë për mësimet e ndryshme.

Gjithashtu edhe mësuesit Gjymnazistë, një lloj edhe ata të dalun nga Teknikja.

Po edhe Normalistët, qi kanë dalë qysh prej vitit 1924 e deri më sot, duhet të bashkëpunojmë me vllëznit e 'tyne më të vegjël e të mos kujtojnë se me mbarimin e shkollës mbaroi edhe detyra e 'tyne shoqërore. Pra të mos i harrojnë bankat, ku rrijshim më përpara, pse po n'ato po rrijnë edhe shokët e 'tyne, të cilët po e gatuojnë këtë brum.

Qëllimi i im është qi të gjithë shka janë mësues të rrafinit mendimet e 'tyne në këte të përmuejshme pedagogjike tue kallzue edhe sistemet e methudhat e ndryshme të mësimet, qi kështu të mund të zgjidhet ajo më e përshtatshmeja e më përfundimtarja për vendin e ambjentin t'onë.

Po të jetë ky bashkpunim i arrihet me të vërtetë qëllimit kryesor, qi nuk është t'jetër, veç ideali i përbashkët për të mirën arsimore.

Nuk duhet pra të thomi se unë jam Gjymnazist a Teknikas e nuk shkruaj në të përkohëshmen "Normalisti", ose të thomi: "unë i kam mësue ata qi e drejtojnë këte rivistë, qysh të bashkëpunoj me një nxënësin t'im? . . ." Ky është një mendim shumë i gabueshëm.

Duhet pra t'i hedhim poshtë këta mendime, e, në mendofshim se të gjithë jemi një e kemi po një ideal, mendjet duhet të rrihen pa t'jetër ndërmjet 'tyne, në dashim qi të formojmë kulturën e përbashkët e t'ia mbërrimë qëllimit, për të cilën arsimit i ynë sot çfaq nevojën më të madhe, mbassi gjindet në periodën e ëndjes e të shtjellimit

Safa '30.

Kopshti dhe Trandafili i zhuritun

Drejtorit t'em të Fillores, arsimtarit plak, të
ndyerit Nikollia Mitaces, i cili vdiq në
Korçë në Vjeshtë të parë 1932

Po e shikoj . . . po . . . me ëndje dhe me habi se si është tue lulëzue një kopsht i gjënë, i math dhe i bukur tejet.

Mbrenda ka gjithëfarë lulesh : luledielli, lule gojëluani, lule misiri e të tjera, . . . por ka edhe shumë trandofila të bukura. Rreth e përçark kopshtit gjinden pemë gjithëfarësh, nëpër të cilat fluturojnë për bukuri bilbilat e verdhë, që e mbushin ushëtimën e kopshtit madhështor me melodit e 'tyne të këndshme . . . Njerës, duket të lumtun, pa ndonji kujdesje dhe me gjithë të mirat, shkelin me krenari mbi këtë kopsht të bukur, edhe në të katër anët shkëlqen një hyll, . . . një dritë madhështore.

— Deh, moj e hyjnueshme e padukun, ç'farë është ky kopsht: parais toke a po parais Qielli?! . . . A thue këtu mbrenda nuk do të ketë fare idhnime dhe dëshpërime? A nuk njëzet fare prej këtyne njerëzve rrena, smira, pabesia dhe ahmarrja e botës s'onë?

. . . Uh, . . . jo! . . . S'ka vend plot me të mira, . . . s'ka njerës të ngopun me lumtuni, . . . s'ka lule pa brenga! . . . Ja atje tej shifet një manushaqe pak e venitun; më të djathtë një lule shqerre është me kokë t'ulun për tokë, thuej se hapësina ka rëndue tepër mbi 'të! Brij 'saj një lule gojëluani hap dhe mbyll pa dashun fletët e 'saja: ndoshta ka etje për ujë e don me përpimun dishka të lëngëshme. Më të majtë një lule dielli ul e ngrënë në kohë të caktueme kokën e 'saj dhe, kur merr drejtqendrim, ndigjohet një **o f s h**, . . . një **a h** i rëndë dhe i vrazhët.

. . . Hyj edhe unë mbrenda në kopsht dhe ec me çapa të rregullshëm e të matun. Kam frikë me e rëndue shumë trupin mbi këmbët e mija, se mos shkel për vdekje lulet e pafajshme, qi shtrihen an' e kënd kopshtit. Çdo gjë e verej me habi! Njerëzit nuk u-çuen me më shoqënie; ata rrijnë larg meje e më verejnë me sy të shtrembët. A thue se u kam prishun lumtënin e 'tyne?! Me gjithë atë unë ec, . . . ec gjithëmonë përpara. Kaloj përmes luleve e ato të gjitha përuhin kryet. Ndoshta më përshtëndesin, por unë nuk i kuptoj. Vetëm mendja e ime mendon dishka, e dëshira nuk pajtohet me 'te. Mendja i thotë vehtes ndalo-u këtu dhe pyet dishka, por dëshira, — ah kjo e pangopun! — . . . e urdhëron vehten t'ime të shkojë përpara, se don me pa gjana të bukura e të panjoftuna. E unë i përullem dëshirës dhe përsëri po ec, . . . ec nëpër kopsht e nuk ndalem! Një ç'është shkon nëpër medjen t'ime e kjo pyetje percillet me një **hesht** të dëshirës s'ime, dhe . . . kurgjâ t'jetër.

Iu afrova një njeriut dhe i them: "mirë mëngjes, o njeri i Zotit!," Ai më verejtë me të keq, rrudhi ballin dhe vetullat, përplasi këmbët, mblodhi grushtat e duervet dhe . . . kurgjâ. Iku me vrap tue pëshpëritun dishka. Unë përsëri nuk tutem, por báj punën e zakonëshme, d. m. th. po ec,

Ndalem nën hijen e njëj drûje molle. Zgjas dorën e këpus një mollë dhe e futa në gojë për me e kafshue, por . . . e hodha me një herë për tokë, se ajo ishte shumë e idhët . . . Po vë veshin me kujdes për me ndigjue, se sipër mollës një bilbil i verdhë filloi me këndue. Por, ah! . . . nuk këndonte për gëzim, sikurse kujtojshem unë përjashta kopshtit. Ai këndonte një melodi të mallëngjyshme, qi të bënte, pa dashun, me lotue! Largo hem prej andej e po i bie rrotull kopshtit. Afrohem ke grumbujt e trandafileve dhe ndalem për me i shikue: disa shkëlqejshin nga bukuria dhe kishin erë shumë të këndëshme, kurse të tjerët ishin të venitun, . . . të vyshkun fare, gadi sa s'u kishin rënë fletët.

N' atë kohë një insekt i dâmëshëm erdhi me sulm dhe i drejtue një trandafilin. Unë zgjata shkopin për me i rënë insektit, por shkopin, për mrekulli, s'mundesha me e ngritë, se pa pandehun ishte bënë shumë i rëndë! . . . Insekti zgjati grepin e 'tij të helmueshëm dhe i shkëputi trandafilin një fletë e me të shpejtë iku. Por për ku? . . . Ndejta edhe pak kohë dhe shof se trandafilin filloi me u-vyshkun e më në fund . . . u-venit fare! Por për çudi nuk e humbi aspak erën e këndëshme

Shkova më tutje e më larg dhe pashë lule, zoq, njerës edhe kurgjâ t'jetër . . . Vojta edhe një herë ke grumbujt e trandafilave. Trandafilin, qi i këputi insekti një fletë, kishte ende, erën e këndëshme. Afrohem t'u marr erë edhe trandafilave të tjerë të venitun, . . . por, jo, . . . ata nuk kishin fare. Mbas pak shof me habi se trandafilin i zhuritun dhe erëkëndëshëm e zmadhoi vëllimin e 'tij e pa pandehun nga qendra e 'tij duel një bilbil i bardhë. Bilbili i mrekullueshëm filloi me këndue shumë këngë gazmore, dhe gjithë trandafilat e venitun muerën bukurin e më përparëshme; njerzit larg meje përqafeshin me buzë në gas, edhe unë gadi sa s'kërcejshem prej lumnis Por ah, ! Nuk shkoi shumë kohë e gazi u-prish, se Bilbili i mrekullueshëm fluturoi nalt, shumë nalt në qiell, për udhë të pasosun e të panjofturn, dhe trandafilin i venitun e erëkëndëshëm, qi nxorri

zogun e mrekullueshëm, shpërdau në hapësinë gjethet e 'tij, edhe vendi, ku rritesh, mbeti lakuriq e i shkretë!

St. Spasse, 32.

Sporti edhe mjeku

Nga praktika shtyhem të them se sporti ka edhe duhet të ketë një lidhje të ngushtë me mjekun. Sikurse e dijmë edukata fizike përgjithnisht mbështetet mbi ligjët e mbi shkencat biologjike të trupit të njeriut, mbi ligjët e mjeksis. Jo vetëm nga kjo por praktika na e kallzon se, për me u-ba një sport i arsyeshëm e higjienik me qëllim shëndetsuer ose edhe me qëllim për me u-ba një kampion, është nevoja që shpesh herë të kishillohemi ose të verehemi prej mjekut. Shpesh herë djelmoshat, tue u-praktikue në sport, ndeshin në gabime të stërvitjevet, e teprojnë ose nuk e përshtasin ashtu si e aqë sa duhet. Ndodh shpesh e shpesh që nxansit ose sportistat, tue i mbushë mushkënit e 'tyne e tue e pastruem gjakun me ajrin e pastër të fushaveve sportive, rrëxohen, vriten keq, u thyhet ose u ndrydhet ndonji gjymtyrë e trupit, ftohen ose u ngjanë ndonji fjetër send në trup, etj. etj. Në të gjitha këto raste pra sportisti do t'i përplasat drejt për së drejti mjekut, i cili tashti me mjeshtrin e 'tij do të dijë se si me e drejtue sportistin, për me praktikue sportin e arsyeshëm e se si me e shërue atë të plaguemin ose të sëmundin.

Jo vetëm nga këto pikëpamje, por edhe nga të tjera, sporti ka një lidhje të ngushtë me mjekun ose me mjeksin. Lufta e Madhe ka lënë ndër ushtarët e oficerat e atëhershëm mjaft nerva e gjymtyra të pime e të pazôjat për punën e vet dhe gjatë kësaj lufte mjekët shumë të zotët në degën e 'tyne përdorën shumë barna për ringjalljen e këtyne nervave e gjymtyrave. Një nga këta barna shumë i mirë e i përshtatshëm i këtyne sëmundjeve, që u-përdor e që përdoret edhe sot, është **sporti mjeksuer**. Mirpo këtu me fjalët, sport mjeksuer, nuk kuptojmë të gjithë edukatën fizike, gjithë ushtrimet trupore, etj, por kuptojmë vetëm një degë të 'saj, d. m. th degën e **sportit mjeksuer**. Kjo degë përmbledh të fërkuemet, që u bâhen sportistave, si bânjat e ujit, f'ajrit të diellit dhe atë grup ushtrimesh, që shërben për të ndrequnit e të ringjallunit e organeve e të gjymtyrave të ndryshme të trupit të njeriut.

Në Shtetet Veriore t'Europës zbërtheu mbas Luftës një lulezim i gjallë e i vazhdueshëm botimesh (gazeta, revista e libra), ndër të cilat bisedohesh këjo degë e edukatës fizike. Por më disa vende të tjera t'Europës, me gjithë qi nuk mungojshin fletoret e përditshme, nëpër të cilat botoheshin ndeshjet e fitimet e kampionvet të ndryshme, por mungojshin ato njohni shkencore, qi kqyrin e qi studjojnë këtë degë t'edukatës fizike, d. m. th. të fërkuemit, gjymnastikën hygjienike dhe sportin e arsyeshëm. Me fjalët sport i arsyeshëm kuptojmë atë grup ushtrimesh e stërvitjesh të përditshme, qi janë të përshtatuna mbas ligjëvet të hygjienës e qi janë të domosdoshme për me u-mbajtë njeriu në gjendje të mirë shëndetsoro për gjithëmonë. Sporti i arsyeshëm nuk duhet të jetë vetëm një veprim me qëllim **agonistik** e me qëllim ndeshjesh kampionatesh të ndryshëm, por më përpara të jetë një edukatë fizike e domosdoshme për grupet e institutet, të jetë një ushtrim, qi t'edukojë bashkë me trupin edhe mendjen e shpirtin. Pra sporti si pjesë e edukatës fizike dhe e hygjienës, qi të mund të jetë i vlefshëm për organizmin e qi të mundi të na api atë përparim, qi ne e paramendojmë e e presim si mbas shkencavet, duhet qi ky sport të shqyrtohet prej mjekut. Mjeku sportist, d. m. th. mjeku specialist në degën e sportit, e ka ushtrues mjeshtrin e tij prej shumë kohësh në Gjermani, me emnin "**Sportarzt**". Në Shtetet Veriore t'Europës u-shpik në këtë mënyrë dega "**mjekësia sportive**".

Ndyrhymja mjeksore në fazat e ndryshme sportive është pa t'jetër e domosdoshme tue fillue nga gjënat më t'imita e në moshat më të vogla. Mjeku duhet të merret me këtë degë të rëndësishme të mjeksis, edhe aqë më mirë do t'ishte, sikur ai vetë të bëhet një sportist për me kuptue e me provue në vehten e vet të mirën e ushtrimit trupuer dhe me njoftë teorikisht e praktikisht gjymnastikën e vërtetë e sportin mjeksuer.

Nuk duhet të ndajmë pra sportin mjeksuer prej gjymnastikës së përgjithme, gjë qi është e pamundun për edukatorin fizik (edukatori fizik duhet t'i përdori të dyja).

Mjeku modern duhet të ketë njohni për çdo degë të ndryshme të gjymnastikës dhe me e trajtue si një nga pjesët më kryesore të hygjienës pozitive; ai duhet të ketë kaqë njohni të thella për këtë pjesë të mjeshtris së tij, sa qi të dijë me ua urdhënue në kohën e në vendin e duhun të shëndoshve e të

sëmundëve.

Pra, në qoftë se duem të nxjerrim një fitim prej sportit, si përmirësues e riformues të gjendjes së përgjithshme popullore, duhet që mjekët e zotë t'i kqyrin se ç'po bëjnë sportistat, t'i këshillojnë e t'i drejtojnë, sikurse veprojnë edhe nëpër vende të tjera, ku sporti e përgjithnisht edukata fizike përparon dita me ditë.

Përkthye e shtuë prej

A. Lleshanakut '30.

Vjerrsha për shkolla fillore.

Harabelat e vegjel.

Ca zoq t'vegjël, harabela,
Mbetë pa nanë,
Nji huti u-zhyt si fela
Me i ngranë.

Ciu, ciu zoqt në çerdhe qanë
E ranë përdhé,
Sikur dojshin me i thanë:
" Ç' ke me ne ? „

Ndihmoni të vorfnit!

Kur me turp trokit në derë,
" Tak, tak, tak „
Nji i vorfën, nji i mjerë,
S' t' dhimset pak ?
Tuj u-dridhun kur të vjen
Me gjetë hirë,
Pse mbyll derën dh'e përzën ?
S' ke mëshirë ? .

Qukapiku '33.

Lopa

1) Në fushë plot me bar,
Një lopë kullot e rri,
Nga shoqet është ndarë,
Shkon për në shtëpi.

2) Për në shtëpi shkon,
My, my, duke pallë,
Viçin s'e harron,
Po në gji e kallë.

3) Me një kusë del
Zonja në shtëpi,
Lopën si e mbjel,
Viçin le e pi.

4) Viçi mirë si pi,
Veç lopën e ndajnë,
Plot bërë e tagji
I hedhin mbasandaj.

J. Ngurza '29.

Vjollca

N'per bar e ferra
Mshëhë pa madhshti,
Lshoj erë të kandshme
T'gjith m'donë tepri,
Pse une vjollca
Veç lulësh t'jera
Gzoj njerzit tuj thanun
Mbrini pranvera!

Pranvera

Me tjera lule
Vjollca sa bini,
Bertiti t'madhe:
Pranvera m'brini
E zogj e bëca
T'gjithi shend si vera
Mei' herë vikatën
Rrnoftë, rrnoftë pranvera.
Z. N. Pali '30.

Fjalë t'urta.

Shumë ndëgjo dhe pakë thuj.
Gjete kishë të falesh!
Më sa ha pula koprën, kaq' e do motra motrën.
Umbars mali e polli një mi.
Mos thuj gjithënjë se ç'mendon, por mendo se ç'thua.
Njëra dorë lanë t'jatrën dhe të dyja lajnë faqet.
Syri i fqinjit është gjithënjë i keq.
Gruaja të bën atë, që nuk mundet të ta bëjë as shejtani.
Sytë që nuk shikohen, shpejt harrohen.
Dardhën e ndykur e ha breshka.
Kij-i frikë, atij që të ka frikën.
Zoti na ruajtë nga lumi i trubull.
Tek kalle (fute) këmbët, të rënçin dhëmbët.
Pa guxim, asnjë përparim.
Të pështynç lart, të bije në fytyrë, të pështynç poshtë,
të bije gjirit.
Qesh hunda për buzën.

Ndize dritën, përpara se të zërë nata.
 Po gjete shesh, bëhe përshesh.
 I bije cylvës me një vrymë.
 Po të përpiqen dy vezë, njëra do të thyhet.
 Kush i ndrron shpesh çesmat, thyen më në fund shtëmbën.
 Ç'ndëgjon në gjitoni (fqinjët), prite në shtëpi.
 Gjetkë kakarisin, gjetkë pjellin pulat.
 Dor' e mbyllur nuk ze miza
 Për hatër të thëllëzës, mos ia nxirr syn korbit.
 Frika bën këmbë, dhe urija dhëmbë.
 Duart e shumta janë të bekuara, po gojët e shumta të mallkuara.
 Ka mbetur rrip daulle (ka rënë ngusht në vobeksi).
 Ç'të duhet dasma në Karabunarë.
 Dhëlpër e veshur me lëkurë qëngji.
 Më rrove të rrova brisku i berberit.
 Ngado që të shkonç, në Kuman do dalç.
 Nga trualli i lik ik, po nga njeriu i lik mos ik.
 Hyr në arapët, zgjith më të bardhin.
 Pula s'ke, me dhëlpër pse lufton ?
 Mos u-bëj berber në kokët të botës !
 I zofi do, tellalli (kasneci) s'do.
 Shih nënën, merr-i të bijën
 Perëndija të ruajtë nga zabiti (oficeri) áxhami (i pastërvitur), nga zengjini (pasanik) i ri dhe nga fukarallëku (vobeksija) në pleqëri.
 Hall me qe, hall me buaj ; buajt duan lerosur qet i ha zegali . . .
 Dhënt e dhit e Zeres, nami i Kapllan Qeres.
 Bëj nënë të të ngjajë.
 Nji shkëndi ndez kaq male.
 Monastiri shëndosh, pa kollagjerë ka plot.
 Në të lënçin për prift, bëhu dhespot.
 Ty s'të qasin në fshat, ti kërkon të bijen e priftit.
 Ara në malt s'ke, dava me çakejt pse bën ?
 Do t'i themi dërrit dajo.
 Afër jemi, po s'piqemi.
 Hatëri të nxjerr nga gjëri (gjaja, pasja).
 Nuk bën miza mjaltë.

Ç'shpreson nga hallva e vdekur (njeriu i frikshëm).

Uji i qetë shpon malin.

Dora, që s'kafshohet, puthet.

Mbledhun prej
VII. Papathanasit

Për ata qi s'di hesht e për ata që din thuej ato që duhen.

E liga fluturon, dhe e mira çalon.

Përbuzja e lavdimeve është një dëshirë që të lavdohet njeriu prapë.

Njeriu i mirë dëshironet, njeriu me karakter nderonet.

Fol mirë për të tjerët dhe nuk do të pendonesh kurrë.

Kur është njeriu i rreptë atje ku duhet, nuk është i rreptë atje ku duhet.

Perëndija rrobet i ndanë si mbas të ftohtit.

Kusari dhe gënjeshtari vitin e parë gëzon.

Kur bisedojmë me miqt, duhet të kemi ndër ment se nesër munt të bënemi armiq me 'ta.

Mos u-mburr kurrë me mënt, as me fis, as me ergjënd.

Mos u-mburr se din të shkruash, por duhet të dijsjsh ç'të thuash.

Mos u-mburr kaqë me diplomë, se trutë nuk t'i ka ndërrue.

Mbledhun prej
Noftit Ciko

Anekdotë

Dy miq kuvendojnë

- Shum i dobishëm është ky shiu i Vjeshtës së dytë; ç'gjin-det mbrenda në dhé do të mbijë me një herë.
- Këjo është një fatkeqsi e madhe.
- Pse?
- Kam të mbulueme në dhé katër gra.

Në rrugë

- Më huan, të lutem, 50 franga?
- Nuk mbaj me vehte të holla.
- Dhe në shtëpi?
- Të gjithë mirë, falemi nderës!

Qumështshitësi

- Sa qumësht mjel për çdo ditë nga lopët t'ua?
- Pesëmëdhetë okë.
- Dhe sa shet prej 'tyne?
- Tridhetë deri tridhet' e pesë okë, u-përgjigj qumështshitësi.

Përgjigje e pagueme

I ati pyet djalin e vet:

- Qysh? Je i zoti në zoologji? Më thuej të lutem, bir, i em, cila është ajo kafshë, që vjen në shtëpi e ngarkueme? Mbassi mendohet:—baba!!!

Squetësija e katundarit

Ludoviku i XVtë po inspektonte ushtërinë e vet.

Nji katundar, që kishte mbijellë bezele në nji arë të 'tij e gjeti këtë plot me ushtarë Helvetianë, që po shetisshin nëpër 'to tue i shkelun me këmbë.

Zuni me nji herë të bërtasi fort:

- Çudi!, çudi!
— Ç'ke, more zotni i mirë,-i tha nji oficer,-që bërtet kështu? Katundari, pa i u-përgjegjë, po vijonte të bërtitte sa më fort: Çudi, çudi! sa që tërhoqi vërejtjen e mbretit.

Madhnija e 'tij i tha t'afërohet edhe e pyeti që përse bërtiti n'atë mënyrë.

— Unë, madhni, i u-përgjigj katundari, kishja mbijellë n'arën t'eme bëzelë edhe ato mbinë ushtarë. Nuk është këjo nji çudi?

Squetësija e 'tij e bëni me qeshë mbretin, i cili urdhënoi të shpërblehet katundari shpejt e shpejt

Shpejtësi

— Jani — thotë zoja tue dalë — në qoftë se vjen ai zotnija, që do të marri shtëpin me qira ose zoja e 'tij, t'iu thuesh të më presin. Nuk do të vonohem jashtë.

Mbas pak vjen nji zotni e trokit në derët; Jani e hapi.

- Jini zotnija, që do të merrni shtëpin me qira?
— Jo, u-përgjigj ai.
— Atëhere pra do të jini zoja e tij; urdhënoni mbrenda.

Në gjygj

Gjykatësi:— Kur se ti ngul këmbë se nuk ke qënë në pyll, si atëhere të pa rojtësi i pyllit mbrapa nji peme?

I gjykuemi:— Pse pema nuk ishte mjaft e trashë.

Mbreti dhe katundari

Mbreti i Francës, Enriku i IVtë, kur ishte tue gjuejtun, e zgjati mjaft shëtitjen e 'tij në pyll.

Atje gjeti nji katundar, që po rrinte ndën nji pemë dhe e pyeti: Ç'bàn aty?

— Pres të shkojë mbreti që ta shof.

— Eja pas meje në kal edhe do t'a tregoj unë shumë lehtë.

Katundari e pranoi këtë edhe hipi në vithet e kalit. Në rrugë pyeti se qysh do të mundesh të njofi mbretin.

— Do të vështrojsh, tha Enriku, atë që do të mbajë kësulën në kokë, kur të gjithë i kanë hequn të 'tynet.

Pas pak mbreti takoi me njerzit e vet të cilët, porsa e panë, i nxuerën kësulat.

— Tash pra, e pyeti mbreti katundarin, kush është mbreti?

— Për Zotin, u-përgjigj katundari. a do të jesh ti a unë, pse vetëm ne të dy jemi me kësulë në kokë.

Mbledhun prej

Villas Papathanasit

Lajmet e shkollës

Festa e vitit të ri n'Internat, më 31 të Shëndreut 1932. — Programi e kësaj feste me parullën D. V. D. '33 që shpërndamë ditën e 31 Shëndreut. Në mbramje mbas darke të gjithë nxënësit, të mbrendëshëm e të jashtëm, u-mblodhën në sallën e bukës, në të cilën veç të t'jerave në fund qëndronte dhe një skenë e përgatitun. Këtë natë urdhnuen dhe disa nga mësuesit Normalistë të qytetit.

Së parit, si mbas programës, Z. V. Andoni, nëndrejtor' i Internatit, nisi fjalimin tue bërë që të gjithë të drejtoheshin kah ai. Për afër një orë rresht të gjithë mbetën në heshtje, tue ndigjue e në fund Z. Andoni mbylli fjalimin po me fjalët e ëmbla të themës: " nuk pò ju them, siç është zakoni, e gëzofshi vitin e ri, por **shiko natë e rri i ri**.. Duertrokitjet s'pushuen për mjaft kohë, e të gjithë mbetën të kënaqun, se sikur diçka ndiejshin së mbrendëshmi.

Mbas një pushimi të vogël u-luejtën pjesa të ndryshme muzikore prej nxënësve të shkollës.

Rendi '33 çfaqti komedin. "Dy shërbetorët me një pamje e me pjesa muzike ndërmjet.

Vjen ora a po çastit, kur do të hyjë viti i ri. Një heshtje e plotë mbretnon. Ulen llambat e në skenën e mbyllun me perde diçka është përgatitë. Vjen koha e caktueme e për një herë, n'atë çast kur vjeti 1932 na la lamtumirën, u-hap skena e përpara syve duket një trekandsh i madh i zburkruem e i shkruem: D. V. D. '33. Kjo është parulla e mçefët e Rendit maturant. Devedeasit,

(kështu thirret Rendi '33), t'ulun kâmbëkryq, rrijshtin, duket, nën hije të parullës së 'tyne.

Mbas kësaj pune këndohen letra urimesh të dërgueme prej parashkuesve Normalistë. Këndohet së pari letra e St. Spasses '32 bashkë me mësuesit Normalistë te Fushës së Dropullit. Mandej këndohet letra e R. Hoxhës '31, mësues në Bilisht. Ndigjohen duertrokitje.

Pastaj Q. Guranjaku '33 përshëndeti motin e ri me një vjerrshë. Hapet një si punë fushate për t'u mbledhë ndihma për "Normalistin". Puna shkoi fare mirë, e "Normalisti," falnderon të gjithë atë që futën dorën në xhep për t'ë Nder nxënësit u-shquen Xh. Ndreu '36, A. Tanefi '35 e K. Sevo '33, që paguen seicili nga 5 fr. ari; Z. Z. Vasil Andoni, Stiliano Gaxho e Karl Ljarja, profesorët t'onë, paguen të tre 20 fr. ari tue i sigurue "Normalistit," 60 fr. ari gjithsejt.

Mbas këtyne punëve u-këndue prej Z. Nëndrejtor një vjerrshë satirike, me ânën e së cilës Zhiti H. '32 na uronte vitin e ri. Gazi e të përplasuna duersh ndigjoheshin gjithkah, pse Zhiti ia din msheftësit jetës së nxënësit. Të gjithë ngelën shumë të kënaqun e i luten Zhitit, që të mos harrojë dhe për vitin t'jetër.

Mâ në fund, kur gëzimi kishte mbërri në kulm, u-shpërndanë dhuratat e vitit të ri, që këta vjetë janë bënë si zakon në shkollën t'onë.

Më 7. I. '33 Z. Piro Minga, profesor i Ushtrimores së Normales, foli në klubin e Elbasanit për koedukacionin. Fjalimi zgjati mjaft e u-prit me duertrokitje prej ndigjuesve.

Më 14. I. '33 Z. Kasem Bajrami foli në klub t'Elbasanit për zhvillimin e individualitetit e për naltësimin e grues Shqiptare. Fjalimi zgjati mjaft e u-mbulue me duertrokitje.

Përsëri më 4. II. '33 Z. Piro Minga foli në klub për të mos rriturit e fëmij drejt së drejti me ndjenja fetare.

Më 26. I '33, për pushimet e Bajramit të Madh, Rendi '33 shkoi në Tiranë, ku në Cineman "Nacional," shfaqti dramën "Fë e Kombësi," t'advokat Kr. Floqit, të cilën vjet e pat luejtë ky rend me sukses të madh n'Elbasan.

Rendi '33, i udhëhequn prej Z. V. Andonit, e bëni punën e vet si duhet, e të gjithë pasardhësit duhet, natyrisht tue ndjekë

dhe parullën e Shkollës s'onë: "nalt e mâ nalt e mirë e mâ mirë,, ta kenë si shembull. Veç kësaj ky rend e mbarë gjithë shkolla i falen nderit Ministris s'Arsimit, e cila dha përkrahjen e duhun.

Më 11. I. '33 Shkolla e jonë i pushoi mësimet për 10 ditë nga shkaku i njëj sëmundjeje, qi u-përhap në qytet. Mësimet nisën prapë më 21 të Kallëndorit.

Më 12. III. 33 Z Kasem Bajrami, profesor i Shkollës s'onë, u-martue me zonjushën Drita Toto. "Normalisti,, i dërgon urimet e veta e lut të trashigohen.

Më 21. XII. '32 nisi kampionati i basketboll-it ndërmjet klasëve dhe mbaroi më 8. III. 933.

Më 13.III.933 nisi kampionati i futboll-it ndërmjet klasëve dhe mbaroi më 30. III. 933. Sikurse futboll-in, kështu dhe këto dy loja i fitoi Rendi '33, i cili duket sheshazi se mban kryesin, jo vetëm si rend, por edhe në çdo send t'jetrë.

Më 5. III. '33 Shkolla Normale bëni një ndeshje futboll-i me Shkollën Tregtare në Vlonë. Përfundimi qe 2:1 me fitim të shkollës Tregtare. Falnderojmë shkollën Tregtare për mirë-prijjen qi u bëni lojtarëve t'onë.

Më 13-IV-'33 erdhën këtu nxânësit e Shkollës Tregtare për me përsëritë lojën me Shkollën t'onë. Në mbramje Z. V. Andoni, kur të gjithë qemë mbledhë në sallën e bukës, u uroi mirëseardhjen shokëve t'onë. Mandej foli mjaft kohë për sportin, për dobin qi sjell ky mâ fort në punë morale e mendo-re.

Z. Andoni e zgjati fjalimin mjaft e shkoi mandej gjatë prej njëj bashkimi sportiv në një bashkim kombëtar tue i quejtë të dy si detyra të nxânësve. "Nxânësit janë shembulla mâ e naltë për popullin,, tha Z. nëndrejtor.

Të nesërmen në mëngjes u-bâ një ndeshje volibolli ndërmjet Tregtares e Normales. Fitoi Tregtarja.

Fjalimi u-mbyll me duertrokitje të nxehta. Mandej u-luej-tën pjesa muzikore.

Mbas dreke u-ba ndeshja e futbollit, për të cilën të dy palët janë për t'u-lavdue, sidomos në pikpamje morale. Përfundimi qe 2:1 në fitim të Normales. Nxânësit e Tregtares erdhën si shokë e shkuen si vëllazën,

Muzeu i Shkollës Normale

Posta e jonë.

Z. H. Ballshi—Mallkastër—Muerëm letrat dhe pesë fr. ari, qi na dërguet Ju falemi nderit shum. Do të veprojmë si na shkrueni.

Z. A. Domini-Korçë—Kemi marrë letrat t'ueja dhe 40 fr. ari Ju falemi tepër. Kujdesi i juej u-bâftë shembull për të tjerët. Do të veprojmë si na shkrueni.

Z. Koço Stefani—Odrîçan—Ju falemi nderit shum për kujdesin, qi rrëfeni për "Normalistin". Dhetë fr. ari i muerëm.

Z. Zef Pali—Shkodër—Muerëm letrën t'uej qi, na gëzoi pa masë. Presim me padurim ndonji shkrim.

Z. P. Fiezi—Mat—Kemi marrë letrat t'ueja të dashtuna. Do të veprojmë si na shkrueni, Kujdesi i juej qoftë shembull për të tjerët.

Z. St. Spasse—Dervîçan—Gjithë letrat e shkrimet t'ueja i kemi marrë. Ju falemi nderit shum. Do të veprojmë si na shkrueni.

Z. V. Nasto—Çatistë—Kemi marrë shkrimin t'uej, Ju falemi nderit shum. Lutemi mos vononi për ndonji t'jetrë.

Z. A. Çanga—Peshkopi—Muerëm letrën t'uej. Ju falemi nderit shum.

Z. H. Hodo—Vlorë—Kemi marrë letrat t'ueja. Ju falemi nderit

Z. I. Ngurza—Vlorë—Muerëm letrën dhe pesë fr. ari, qi na dërguet. Ju falemi nderit shum.

Z. I. Kobo Borshi—Mallakastër—Letra e juej e mbushun plot me fjalë të mira na ra në dorë bashkë me ndihmën prej 5 fr. ari, Normalisti është shum i lumtun dhe pret me kënaqsi dëshirën t'uej.

Z. Vilas Papathanasi—Mallakastër—Muerëm letrën dhe artikullin t'uej. Perkraha e juej e nxehtë qoftë shembull për gjithë të tjerët.

Z. M. Ahmeti—Dhuvjan—Muerëm letrën dhe 5 fr. ari. Ju falemi nderit pa masë

Ju lutemi shum gjithë atyne, qi janë ngarkue me të shpërndamen e Normalistit, të na dërgojnë emnat e pajtimtarve. M'ânë t'jetrë ju lutemi gjithë lexuesave, qi të mos harrojnë se "Normalisti", ka nevojë dhe për ndihmë morale.

Vonesa e "Normalistit", vjen jo vetëm nga ai shkak, qi e dini, por edhe nga mungesa e lândës.